



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Performancës

MBËSHTETJA E NXËNËSVE ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME TË ULËTA NË KOSOVË



Prishtinë, gusht 2026

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000) si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë , efikasitetit dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të performancës “Mbështetja e Nxënësve me Nevoja të Veçanta në Shkollat Filllore dhe të Mesme të Ulëta në Kosovë”, në konsultim me Drejtorin e Departamentit të Auditimit të Performances, Ariana Gjonbalaj Shala, e cila e ka mbikëqyrur dhe menaxhuar auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Alba Keqa Bejtullahu, Udhëheqëse e Ekipit të Auditimit

Kujtesa Alaj, Anëtare e Ekipit të Auditimit

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	1
1 Hyrje.....	4
2 Objektiva dhe pyetjet e auditimit	9
Pyetjet e auditimit.....	9
3 Gjetjet e auditimit.....	10
3.1 Identifikimi i nevojave	11
3.1.1 Identifikimi i hershëm ekziston, por referimi dhe klasifikimi mbeten jo të formalizuara dhe të pa standardizuara	12
3.1.2 Mosfunksionimi i Ekipit Vlerësues Komunal pengon zbatimin e procedurës së vlerësimit pedagogjik.....	15
3.1.2.1 Ndikimi i mosfunksionimit të Ekipeve Vlerësuese Komunale në vonesa të vlerësimit pedagogjik dhe listat e pritjes.....	19
3.2 Planifikim Mbështetja pedagogjike – (PIA dhe mësimdhënia e diferencuar)	22
3.2.1 Planet Individuale Arsimore nuk hartohen dhe rishikohen në mënyrë të standardizuar	22
3.2.2 Mësimdhënia e diferencuar në praktikë.....	26
3.3 Zbatim (Shërbimet mbështetëse - asistentë, staf profesional)	30
3.3.1 DKA-të nuk kanë siguruar kapacitetet e nevojshme për arsimin gjithëpërfshirës ...	30
3.3.2 DKA-të nuk planifikojnë dhe sigurojnë staf mbështetës sipas nevojave reale të nxënësve me Nevoja të Veçanta Arsimore.....	33
3.3.3 Mungesa e psikologëve dhe pedagogëve kufizon mbështetjen profesionale për nxënësit me Nevoja të Veçanta Arsimore	39
3.3.4 Mungesa e udhëzimeve të qarta për bashkëpunimin ndërmjet shkollave dhe asistentëve privatë.....	41
3.4 Mangësi në monitorimin dhe koordinimin nga MASHTI.....	44
3.5 Praktikë e mirë ndërkombëtare në mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore – Rasti i Finlandës.....	48
3 Konkluzionet	51
4 Rekomandimet	53

Shtojca 1. Motivi i auditimit, kriteret, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	
Motivi i auditimit	56
Pyetjet e auditimit.....	58
Kriteret e auditimit	59
Fushëveprimi i auditimit.....	61
Metodologjia.....	62
Përshkrimi i sistemit.....	63
Shtojca 2. Perspektiva e prindërve mbi mbështetjen e nxënësve me NVA	67
Shtojca 3. Përmbledhje e analizës së Planeve Individuale të Arsimit (PIA) në shkollat e përzgjedhura për auditim	70
Shtojca 4. Letërkonfirmimet	72

Lista e shkurtesave

CRPD	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
DAPD	Divizioni për Administrimin e Platformave Digjitale
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
EVK	Ekipi Vlerësues Komunal
FNVA	Fëmijë me Nevoja të Veçanta Arsimore
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
NVA	Nevoja të Veçanta Arsimore
PIA	Plani Individual i Arsimit
PECS	Picture Exchange Communication System
SMIA	Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim
UA	Udhëzim Administrativ
UNICEF	United Nations Children's Fund

Përmbledhje e përgjithshme

Arsimi gjithëpërfshirës është një nga parimet themelore të sistemit arsimor dhe synon të sigurojë që çdo fëmijë, pavarësisht aftësive, vështirësive apo nevojave të tij, të ketë qasje të barabartë në arsim cilësor. Në Kosovë, kjo e drejtë garantohet përmes Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe akteve nënligjore që rregullojnë identifikimin, vlerësimin dhe mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Sipas të dhënave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin shkollor 2024/2025, në klasat e rregullta të arsimit fillor (1-9) janë të integruar 2,571 nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Ky numër tregon se një pjesë e konsiderueshme e nxënësve në sistemin arsimor kanë nevojë për mbështetje të specializuar pedagogjike dhe profesionale.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka audituar efektivitetin e sistemit të mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta publike gjatë periudhës 2022–2025, me fokus në procesin e identifikimit dhe vlerësimit pedagogjik, mbështetjen pedagogjike dhe profesionale që u ofrohet nxënësve, si dhe monitorimin dhe koordinimin institucional të arsimit gjithëpërfshirës. Në kuadër të auditimit janë përfshirë Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Drejtoritë Komunale të Arsimit në Prishtinë, Pejë dhe Mitrovicë, si dhe 10 shkolla publike të përzgjedhura në këto tri komuna.

Sistemi i arsimit gjithëpërfshirës në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta publike në Kosovë ka bazë ligjore dhe institucionale për identifikimin, vlerësimin dhe mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Megjithatë, zbatimi në praktikë nuk siguron ende mbështetje të qëndrueshme, të barabartë dhe funksionale për të gjithë nxënësit me Nevoja të Veçanta Arsimore. Mangësitë janë të pranishme në të gjitha fazat e procesit, nga identifikimi dhe vlerësimi pedagogjik, deri te hartimi i Planeve Individuale Arsimore, ofrimi i mësimdhënies së diferencuar, sigurimi i stafit mbështetës dhe monitorimi nga niveli qendror. Si rezultat, mbështetja për nxënës me Nevoja të Veçanta Arsimore vazhdon të varet në masë të madhe nga kapacitetet lokale, angazhimi individual i shkollave dhe mundësitë e prindërve, në vend se të funksionojë si sistem i standardizuar dhe i monitoruar në nivel vendi.

Procesi i identifikimit dhe vlerësimit pedagogjik nuk funksionon në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha komunat. Në nivel shkolle mungojnë procedura të standardizuara për dokumentimin e vëzhgimeve fillestare, komunikimin me prindërit, referimin e nxënësve për vlerësim pedagogjik dhe klasifikimin e nevojave arsimore. Si rezultat, identifikimi i nxënësve mbështetet kryesisht në praktikat individuale të mësimdhënësve dhe stafit shkollor, duke krijuar dallime në mënyrën e trajtimit të rasteve ndërmjet shkollave. Po ashtu, Ekipet Vlerësuese Komunale nuk kanë funksionuar me kapacitet të plotë profesional në komunat e audituara. Në asnjërën nga komunat nuk ishte siguruar përbërja e plotë profesionale e paraparë, ndërsa në Prishtinë dhe Mitrovicë ekipet nuk kishin qenë funksionale për periudha të caktuara. Kjo ka ndikuar në krijimin e listave të pritjes për vlerësim dhe rivlerësim pedagogjik dhe ka vonuar përcaktimin e mbështetjes së nevojshme për nxënësit. Në mungesë

të vlerësimit me kohë, nxënësit rrezikojnë të vazhdojnë mësimin pa mbështetje të strukturuar dhe pa ndërhyrje të përshtatura me nevojat e tyre.

Mbështetja pedagogjike për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore ofrohet pjesërisht dhe me dallime të konsiderueshme ndërmjet shkollave. Bazuar në të dhënat e analizuara për 64 nxënës të vlerësuar me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e përzgjedhura, auditimi evidentoi se jo të gjithë nxënësit e vlerësuar kishin Plane Individuale të Arsimit aktive, ndërsa në disa raste Planet Individuale të Arsimit nuk ishin rishikuar sipas afateve të përcaktuara ose nuk përmbanin objektiva të matshme dhe indikatorë të qartë për monitorimin e progresit të nxënësit. Megjithatë, auditimi identifikoi edhe praktika të mira në disa shkolla, përfshirë përdorimin e klasave burimore, materialeve didaktike të përshtatura dhe metodave alternative të komunikimit.

Kapacitetet profesionale dhe mbështetëse mbeten të kufizuara në raport me nevojat e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Numri i asistentëve, mësuesve mbështetës, psikologëve dhe pedagogëve mbetet i pamjaftueshëm në raport me numrin dhe nevojat e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Ndërsa standardi i përcaktuar parasheh mbështetje prej një asistenti për një ose dy nxënës me nevoja të veçanta arsimore, në praktikë një asistent mbështet mesatarisht 9 nxënës në Prishtinë, rreth 5–6 nxënës në Pejë dhe rreth 35 nxënës në Mitrovicë. Në disa raste, prindërit kanë raportuar se janë detyruar të sigurojnë vetë mbështetje shtesë për fëmijët e tyre, përfshirë financimin e asistentëve privatë apo shërbimeve të tjera profesionale. Po ashtu, prindërit kanë theksuar nevojën për mbështetje më të individualizuar, aktivitete më praktike dhe rritje të bashkëpunimit ndërmjet shkollës, familjes dhe profesionistëve mbështetës.

Monitorimi dhe koordinimi institucional nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar funksionimin efektiv të sistemit të arsimit gjithëpërfshirës. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nuk ka vendosur mekanizma të mjaftueshëm për monitorimin e funksionimit të Ekipeve Vlerësuese Komunale, zbatimit të Planeve Individuale të Arsimit, cilësisë së të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim dhe nevojave reale për staf mbështetës. Auditimi evidentoi mospërputhje ndërmjet numrit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore të raportuar në Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim dhe gjendjes reale të evidentuar në shkolla, duke ngritur pikëpyetje mbi saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave që përdoren për monitorim dhe planifikim. Mungojnë analiza periodike dhe raportime sistematike mbi gjendjen e arsimit gjithëpërfshirës, ndërsa bashkëpunimi dhe komunikimi me komunat nuk siguron adresimin në kohë të sfidave të evidentuara në terren.

Për të adresuar mangësitë e identifikuara, 14 rekomandime janë dhënë për entitetet e përfshira në auditim. Prej tyre, pesë rekomandime i adresohen Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, gjashtë rekomandime janë të përbashkëta për tri Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) të audituara, dy rekomandime janë specifike për DKA-në e Prishtinës, ndërsa një rekomandim i përbashkët i adresohet DKA-ve të Pejës dhe Mitrovicës.

Përgjigjja e entiteteve të përfshira në auditim

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka paraqitur komente gjatë fazës së shqyrtimit të draft-raportit, të cilat janë analizuar dhe, aty ku janë vlerësuar të arsyeshme dhe të mbështetura me dëshmi, janë reflektuar në raport.

Komuna Mitrovicë dhe Pejë janë pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit dhe janë zotuar se do t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna. Komuna e Prishtinës nuk ka dërguar komente dhe as letër konfirmim.

Letër konfirmimin për pranimin e gjetjeve dhe rekomandimeve mund ta gjeni në Shtojcën 4.

1 Hyrje

Arsimi gjithëpërfshirës nuk është vetëm një e drejtë themelore e fëmijëve, por edhe një tregues kyç i funksionimit të shtetit dhe i barazisë sociale. Aftësia e një sistemi arsimor për të përfshirë dhe mbështetur fëmijët me nevoja të veçanta arsimore (tutje NVA)¹ reflekton drejtpërdrejt cilësinë e politikave publike, kapacitetet institucionale dhe nivelin e përgjegjësisë ndaj grupeve më të ndjeshme të shoqërisë. Përveç kornizës kombëtare, arsimi gjithëpërfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore është edhe një detyrim ndërkombëtar për Kosovën. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD)² kërkojnë që shtetet të sigurojnë arsim gjithëpërfshirës, mbështetje individuale dhe shërbime të përshtatshme brenda sistemit të rregullt arsimor.

Megjithatë, raportet ndërkombëtare dhe dokumentet vendore vazhdojnë të evidentojnë se Kosova ka një mungesë të theksuar ndërmjet standardeve ligjore dhe zbatimit praktik, veçanërisht në identifikimin e hershëm, vlerësimin pedagogjik, planifikimin individual dhe ofrimin e mbështetjes funksionale për nxënësit me NVA. Sipas raporteve të UNICEF³ dhe Child Protection Index⁴, vetëm rreth 15–17% e fëmijëve me aftësi të kufizuara janë të përfshirë në arsimin e rregullt, ndërsa një numër i konsiderueshëm i tyre mbeten jashtë sistemit arsimor ose përfitojnë mbështetje minimale dhe jo të standardizuar. Vlerësohet se mijëra fëmijë me aftësi të kufizuara në Kosovë nuk përfitojnë në mënyrë të plotë nga shërbimet arsimore, sociale dhe mbështetëse të garantuara me ligj.

Në praktikë, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në Kosovë orientohen drejt shkollave publike të rregullta ose qendrave burimore/shkollave speciale, varësisht nga lloji dhe shkalla e vështirësisë apo diagnozës së konstatuar nga ekipet profesionale. Sipas statistikave zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (tutje MASHTI) për vitin shkollor 2024/2025, gjithsej 302 nxënës ndjekin mësimin në qendra burimore dhe shkolla speciale, ndërsa 3,872 nxënës me NVA janë të integruar në klasa të rregullta të arsimit parauniversitar. Nga këta, 2,571 nxënës janë të integruar në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët

¹ Me “fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore (NVA)” nënkuptohen fëmijët dhe nxënësit që, për shkak të aftësive të kufizuara fizike, intelektuale, shqisore, emocionale, zhvillimore, vështirësive në të nxënë apo nevojave të tjera specifike edukative dhe funksionale, kanë nevojë për mbështetje të individualizuar dhe përshtatje pedagogjike për të marrë pjesë dhe përfituar në mënyrë efektive nga procesi arsimor në sistemin e rregullt të arsimit. Ky përkufizim bazohet në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në parimet e arsimit gjithëpërfshirës të përcaktuara në dokumentet e MASHTI-t dhe Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD).

² Konventa për të Drejtat e Fëmijës (CRC), nenet 23, 28 dhe 29; Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD), neni 24.

³ UNICEF, Analysis of the Situation of Women and Children in Kosovo 2019

⁴ Child Protection Index 2.0 Kosovo 2017, Implemented by the Coalition of NGOs for Child Protection – KOMF

(klasat 1–9) (fig. 1), duke përbërë pjesën më të madhe të nxënësve me NVA që ndjekin mësimin në shkollat e rregullta.




Figura 1 Numri i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta (klasat 1–9), viti shkollor 2024/2025. Burimi: MASHTI, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2024/2025.

Sipas të dhënave zyrtare, gjatë tri viteve të fundit shkollore në klasat e rregullta të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët janë evidentuar ndërmjet 3,670 dhe 3,900 nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Këto të dhëna tregojnë shtrirjen e nevojës për organizimin e shërbimeve mbështetëse në sistemin arsimor ⁵.




Figura 2 Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të integruar në klasat e rregullta, sipas viteve shkollore. Burimi: MASHTI, Statistikat e Arsimit në Kosovë (2022–2025)

⁵ MASHTI, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2022-2025

Ky trend tregon se integrimi i nxënësve me nevoja të veçanta në sistemin e rregullt arsimor përbën tashmë një realitet që kërkon trajtim të qëndrueshëm dhe afatgjatë, duke rritur nevojën për kapacitete institucionale, staf profesional dhe mekanizma funksionalë të mbështetjes brenda shkollave publike.

Po ashtu, të dhënat tregojnë se nevojat e këtyre nxënësve janë shumë të ndryshme dhe komplekse. Sipas statistikave të MASHTI për vitin shkollor 2024/2025, kategoritë më të shpeshta të vështirësive tek nxënësit me NVA në klasat e rregullta përfshijnë: çrregullimet e spektrit të autizmit (456 nxënës), dëmtimet e të parit (506 nxënës), dëmtimet intelektuale (454 nxënës), çrregullimet emocionale dhe të sjelljes (305 nxënës), vështirësitë në sjellje, komunikim dhe marrëdhënie me të tjerët (330 nxënës), si dhe vështirësitë në mësim në lëndë të caktuara (173 nxënës).

Tabela 1 Numri i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore sipas kategorisë dhe klasës (1-9)

Klasë	Dëmtime intelektuale	Dëmtime të dëgjuarit	Dëmtime të parit	Dëmtime të folurit	Vështirësi në sjellje, komunikim dhe marrëdhënie të tjera	Autizëm	Çrregullime emocionale dhe sjelljes	Vështirësi të mësimin në lëndë	Dëmtime sociale, kulturore dhe gjuhësore	Sindromi Down	Gjithsej
Klasa 1	47	12	41	14	43	110	67	27	5	15	423
Klasa 2	65	17	50	17	51	80	55	19	4	18	425
Klasa 3	47	7	66	14	47	67	42	23	-	15	419
Klasa 4	58	6	63	14	44	56	37	12	-	17	366
Klasa 5	52	7	51	13	28	37	27	16	1	10	282
Klasa 6	48	7	51	20	25	24	24	15	1	6	270
Klasa 7	48	14	76	21	31	28	11	15	1	8	285
Klasa 8	34	11	48	18	30	31	20	37	-	10	251
Klasa 9	35	5	60	7	31	23	22	9	-	12	232
Gjithsej	454	86	506	138	330	456	305	173	12	111	2,571

Përveç këtyre, sistemi përfshin edhe nxënës me dëmtime në të dëgjuar, dëmtime në të folur, sindromin Down, dëmtime sociale, kulturore dhe gjuhësore, si dhe kategori të tjera të nevojave zhvillimore dhe funksionale. Kjo larmi nevojash kërkon qasje të diferencuar pedagogjike, Plane Individuale të Arsimit (tutje PIA)⁶ funksionale, staf profesional të specializuar dhe mbështetje të vazhdueshme në nivel shkolle.

Raporte të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, analiza të organizatave që veprojnë në fushën e arsimit gjithëpërfshirës, si dhe raportimet publike, kanë evidentuar sfida që lidhen me sigurimin e mbështetjes së nevojshme për nxënësit me NVA, përfshirë kapacitetet e kufizuara profesionale, qasjen në shërbime mbështetëse dhe zbatimin e politikave të arsimit gjithëpërfshirës. Këto çështje, së bashku me rëndësinë e kësaj fushe për sistemin arsimor, kanë shërbyer si bazë për iniciimin e këtij auditimi të performancës. Përkundër përpjekjeve për reforma, sistemi arsimor vazhdon të përballet me sfida strukturore, si:

- mungesa e të dhënave të sakta dhe të harmonizuara për nxënësit me NVA;
- vonesa dhe mangësi në procesin e vlerësimit pedagogjik;
- mungesa e asistentëve dhe stafit profesional;
- zbatim formal i Planeve Individuale të Arsimit (PIA);
- kapacitete të kufizuara të qendrave dhe klasave burimore;
- si dhe mungesë e mësimdhënies së diferencuar dhe mbështetjes funksionale në praktikë.

Në shumë shkolla fillore, mësimdhënësit përballen me klasa të mbingarkuara dhe pa mbështetje adekuate profesionale, gjë që ndikon jo vetëm në cilësinë e mësimin për nxënësit me NVA, por edhe në kohën efektive të të nxënësve për gjithë klasën.

Në këtë kontekst, edhe të dhënat e siguruar nga Drejtoritë Komunale të Arsimit (tutje DKA) tregojnë një rritje të vazhdueshme të numrit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore gjatë viteve të fundit, ndërsa numri i asistentëve dhe stafit mbështetës nuk i plotëson nevojat reale të identifikuar. Për shembull, në Komunën e Prishtinës numri i nxënësve me NVA është rritur nga 387 në vitin 2022 në 630 në vitin 2025, ndërsa numri i asistentëve mbështetës ka mbetur 68. Kjo mospërputhje ndërmjet rritjes së nevojave dhe kapaciteteve mbështetëse sinjalizon sfida serioze në planifikimin dhe ofrimin proporcional të mbështetjes arsimore në praktikë.

⁶ Plani Individual i Arsimit (PIA) është dokument pedagogjik që planifikon dhe monitoron mbështetjen arsimore të individualizuar për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Tabela 2 Të dhëna për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe asistentët në komunën e Prishtinës (2022–2025). Burimi: Drejtoria Komunale e Arsimit ne Prishtine

Periudha	Nxënës të vlerësuar nga ekuipi komunal	Nxënës me nevoja të veçanta arsimore	Asistent të punësuar
2022	138	387	68
2023	111	541	
2024	126	553	
2025	119	630	

Kjo mospërputhje e vazhdueshme ndërmjet legjislacionit dhe zbatimit praktik përbën një rrezik të lartë institucional. Edhe pse ligjet, udhëzimet administrative dhe strategjitë kombëtare parashohin arsim gjithëpërfshirës, mbështetje të specializuar dhe qasje të barabartë për të gjithë nxënësit, zbatimi i tyre në nivel qendror, komunal dhe shkollor mbetet i fragmentuar dhe jo gjithmonë efektiv.

Duke marrë parasysh ndikimin afatgjatë që arsimi ka në jetën e fëmijëve dhe në zhvillimin e shoqërisë, ky auditim ka rëndësi të veçantë publike. Ai synon të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi mënyrën se si funksionon sistemi në praktikë, të vlerësojë efektivitetin e masave të ndërmarra dhe të ofrojë rekomandime konkrete për përmirësimin e arsimit gjithëpërfshirës, me qëllim që asnjë fëmijë të mos mbetet pas për shkak të nevojave të tij të veçanta.

2 Objektiva dhe pyetjet e auditimit

Të vlerësohet nëse institucionet përgjegjëse kanë krijuar dhe zbatuar në mënyrë efektive mekanizmat e nevojshëm për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, si dhe nëse këto mekanizma kanë ruajtur cilësinë dhe kohën efektive të të nxënësve në klasë.

Auditimi ka vlerësuar nëse MASHTI, komunat dhe shkollat fillore dhe të mesme të ulëta publike sigurojnë mbështetje reale dhe funksionale për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, përmes identifikimit të duhur të nevojave, zbatimit efektiv të PIA-së, mësimdhënies së diferencuar dhe ofrimit të shërbimeve mbështetëse, duke ruajtur njëkohësisht cilësinë dhe kohën efektive të të nxënësve në klasë.

Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektives së auditimit është parashtruar pyetja si në vijim:

Në çfarë mase mekanizmat për identifikimin, planifikimin dhe zbatimin e mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore janë efektivë dhe ndikojnë pozitivisht në procesin mësimor në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët publik?

Fushëveprimi i këtij auditimi ka përfshirë periudhën 2022–2025 dhe është fokusuar në vlerësimin e efektivitetit të sistemit të mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët publik (klasat 1–9). Në nivel qendror, auditimi ka përfshirë Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), ndërsa në nivel lokal Drejtoritë Komunale të Arsimit në Prishtinë, Pejë dhe Mitrovicë, si dhe 10 shkolla publike të përzgjedhura në këto komuna.

Metodologjia e detajuar e aplikuar gjatë këtij auditimi, problemi i auditimit, kriteret e auditimit, fushëveprimi i auditimit, përshkrimi detaj i sistemit dhe përgjegjësitë e palëve relevante janë paraqitur në *Shtojcën 1* të këtij raporti.

3 Gjetjet e auditimit

Auditimi ka analizuar mënyrën se si identifikohen dhe vlerësohen nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (tutje NVA), si planifikohet dhe zbatohet mbështetja pedagogjike përmes Planeve Individuale të Arsimit (tutje PIA) dhe mësimdhënies së diferencuar, si dhe çfarë shërbimesh mbështetëse u ofrohen nxënësve në praktikë.

Analiza është bazuar në dokumentacionin institucional të MASHTI-t, Drejtorive Komunale të Arsimit (tutje DKA) dhe shkollave, intervista me përfaqësues institucionalë, mësimdhënës, staf profesional, si dhe në vëzhgimet e realizuara gjatë punës në terren në komunat e Prishtinës, Pejës dhe Mitrovicës. Për më tepër, auditimi ka realizuar pyetësorë me prindër të nxënësve me NVA të vlerësuar (Shtojca II), me qëllim të marrjes së perceptimeve të tyre lidhur me qasjen, cilësinë dhe efektivitetin e mbështetjes së ofruar në shkolla.

Përzgjedhja e shkollave në mostër është realizuar duke përdorur qasje të kombinuar të bazuar në rrezik⁷ dhe parimin e diversitetit të rasteve. Në mostër janë përfshirë shkolla me numër të lartë të nxënësve me NVA, shkolla me rritje të papritura të rasteve ndër vite, si dhe shkolla me numër shumë të ulët ose zero raste të raportuara në SMIA, me qëllim të testimit të funksionimit të sistemit në kontekste të ndryshme operacionale.

Auditimi ka përfshirë analizën e 10 shkollave publike në tri komuna, me gjithsej 181 nxënës me NVA në mostër. Mostra ka mundur krahasimin e praktikave të identifikimit, vlerësimit, mbështetjes pedagogjike dhe organizimit të shërbimeve mbështetëse ndërmjet komunave dhe shkollave të ndryshme.

Për qëllime të auditimit, në mostër janë përfshirë pesë shkolla në Komunën e Prishtinës (“Ismail Qemali”, “Hasan Prishtina”, “Meto Bajraktari”, “Emin Duraku” dhe “Dituria”), në të cilat janë identifikuar gjithsej 124 nxënës me NVA, që përfaqësojnë rreth 22.5% të numrit total të nxënësve me NVA në këtë komunë.

Përveç Komunës së Prishtinës, në mostër janë përfshirë edhe shkolla nga Komuna e Pejës dhe Komuna e Mitrovicës, për të mundur krahasimin e situatës ndërmjet komunave dhe për të vlerësuar nëse ekzistojnë dallime në identifikimin e nxënësve me NVA.

Në Komunën e Pejës, në shkollat e përzgjedhura (“Ramiz Sadiku” dhe “Asdreni”) janë identifikuar gjithsej 29 nxënës me NVA, ndërsa në Komunën e Mitrovicës, në shkollat “Anton Zako Çajupi”, “Abdullah Shabani” dhe “Migjeni” janë identifikuar gjithsej 28 nxënës me NVA.

Tabela në vijim paraqet numrin e nxënësve me NVA në secilën nga shkollat e përzgjedhura. Numri prej 181 paraqet të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të identifikuar në 10

⁷ Risk-based Sampling

shkollat e përzgjedhura për auditim, për te cilat kemi bërë analizë të detajuar të dokumentacionit (vlerësimi pedagogjik, PIA dhe mbështetja pedagogjike).

Tabela 3 Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e përzgjedhura sipas komunave

Komuna	Shkolla	Nr. Total i Nxënësve	Nr. I nxënësve me NVA (klasat 1-9)
 Prishtinë	 Ismail Qemali	2889	53
	 Hasan Prishtina	2259	34
	 Meto Bajraktari	1300	33
	 Ennin Duraku	748	4
	 Diturija	179	0
 Mitrovicë	 Abdullah Shabani	1082	1
	 Migjeni	1062	23
	 Anton Zako Çajupi	785	4
 Pejë	 Asdreni	1114	15
	 Ramiz Sadiku	650	14
 Gjithsej		 12,068	 181 (mostra)

Siç shihet nga tabela, numri i nxënësve me NVA ndryshon ndjeshëm jo vetëm ndërmjet shkollave brenda së njëjtës komunë, por edhe ndërmjet komunave të ndryshme.

Kapitujt në vijim paraqesin të gjeturat e auditimit lidhur me identifikimin e nevojave të nxënësve me NVA, planifikimin dhe zbatimin e mbështetjes pedagogjike përmes PIA-së dhe mësimdhënies së diferencuar, dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse, përfshirë asistentët dhe stafin profesional.

3.1 Identifikimi i nevojave

Në këtë kapitull janë paraqitur rezultatet e auditimit sa i përket procesit të identifikimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe funksionimin e mekanizmave të vlerësimit pedagogjik. Analiza përfshin funksionimin e Ekipeve Vlerësuese Komunale (EVK), përbërjen e tyre profesionale, realizimin e vlerësimeve dhe rivlerësimeve, si dhe shkallën e mbulimit të nxënësve me vlerësim pedagogjik në komunat e audituara.

Po ashtu, janë trajtuar sfidat e evidentuara në procesin e vlerësimit, përfshirë rastet e vonesave në vlerësim, mosfunksionimin e ekipeve vlerësuese në disa komuna dhe ndikimin e këtyre mangësive në ofrimin me kohë të mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

3.1.1 Identifikimi i hershëm ekziston, por referimi dhe klasifikimi mbeten jo të formalizuara dhe të pa standardizuara

Shkollat dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit, përmes Ekipeve Vlerësuese Komunale, duhet të identifikojnë dhe referojnë në mënyrë të hershme fëmijët me nevoja të veçanta arsimore për vlerësim pedagogjik, përmes procedurave të qarta, të dokumentuara dhe të standardizuara⁸. Procesi i identifikimit dhe referimit duhet të sigurojë që nevojat e nxënësve të evidentohen dhe dokumentohen në mënyrë të njëtrajtshme, duke mundësuar vlerësim të saktë dhe planifikim adekuat të mbështetjes arsimore⁹.

Identifikimi fillestar i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore realizohet kryesisht në nivel të shkollës, përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë të mësuesve dhe në bashkëpunim me prindërit. Megjithatë, auditimi konstatoi se procesi i identifikimit dhe referimit të nxënësve me NVA nuk zhvillohet në mënyrë të standardizuar dhe ndikohet nga faktorë subjektivë, përfshirë qëndrimet e prindërve, praktikat e ndryshme të shkollave dhe mungesën e procedurave të unifikuara për dokumentimin dhe referimin e rasteve (Shtojca II).

Bazuar në intervistat e zhvilluara me drejtues të shkollave, mësues, mësues mbështetës dhe staf profesional në shkollat e përzgjedhura në Komunën e Prishtinës, rezulton se identifikimi fillestar i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore realizohet kryesisht në nivel të shkollës dhe në bashkëpunim me prindërit. Në shumicën e rasteve, vështirësitë e nxënësve identifikohen përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë të mësuesit gjatë procesit mësimor, sidomos në klasat e para të arsimit fillor, kur fëmijët fillojnë për herë të parë të ndjekin mësimin në mënyrë të strukturuar.

Sipas praktikës së raportuar nga shkollat, në rastet kur një nxënës nuk ka diagnozë paraprake apo nuk është identifikuar më herët si fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, mësuesi i klasës zakonisht ndjek një periudhë vëzhgimi që zgjat afërsisht nga tre deri në gjashtë muaj.

Gjatë kësaj periudhe monitorohet progresi i nxënësit në të nxënë, aftësitë e komunikimit, ndërveprimi me bashkëmoshatarët si dhe sjellja dhe përqendrimi gjatë aktiviteteve në klasë. Ky proces i vëzhgimit u raportua nga shkollat si një praktikë e zakonshme për të dalluar nëse vështirësitë që paraqet nxënësi lidhen me procesin e adaptimit në mjedisin shkollor apo me ndonjë nevojë specifike zhvillimore apo arsimore.

Në rastet kur gjatë kësaj periudhe vërehen vështirësi të vazhdueshme në të nxënë, në komunikim apo në sjellje, mësuesi zakonisht e trajton rastin në bashkëpunim me stafin profesional të shkollës. Në praktikë, kjo nënkupton që mësuesi diskuton vëzhgimet e tij me mësuesin mbështetës, psikologun apo pedagogun e shkollës, si dhe me drejtuesin e

⁸ Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar; UA nr. 02/2024 për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore; Strategjia e Arsimit 2022-2026

⁹ UNICEF, *Situation Analysis*

institucionit. Përmes këtij diskutimi bëhet një vlerësim paraprak i situatës dhe shqyrtohen mundësitë për mbështetje të mëtejshme të nxënësit. Në këtë fazë shpesh përfshihen edhe prindërit, të cilët informohen për vëzhgimet e bëra nga shkolla dhe për nevojën e mundshme për vlerësim më të specializuar.

Pas kësaj, me pëlqimin e prindit, fëmija mund të referohet për:

1. Vlerësim mjekësor në institucionet përkatëse shëndetësore (p.sh. në QKUK ose institucione të tjera) përcakton diagnozën klinike (autizëm, ADHD, dëmtim në të dëgjuar, etj.);si dhe
2. Vlerësim pedagogjik në Ekipin Vlerësues Komunal (EVK); nuk vendos diagnozë, por vlerëson ndikimin që kanë këto vështirësi në procesin e të nxënësit dhe përcakton mbështetjen arsimore që i nevojitet nxënësit.

Pas marrjes së diagnozës ose vlerësimit mjekësor, shkolla, me pëlqimin e prindit, e referon rastin në Drejtorinë Komunale të Arsimit për vlerësim pedagogjik nga Ekipi Vlerësues Komunal (EVK). Diagnoza mjekësore shërben për identifikimin e gjendjes shëndetësore ose çrregullimit zhvillimor, ndërsa Ekipi Vlerësues Komunal nuk përcakton diagnoza mjekësore. Roli i EVK-së është të realizojë vlerësimin pedagogjik, përmes të cilit vlerësohen nevojat arsimore të nxënësit, pengesat që ndikojnë në pjesëmarrjen dhe të nxënësit e tij në shkollë, si dhe përcaktohen format e mbështetjes pedagogjike, shërbimet mbështetëse dhe rekomandimet për hartimin e Planit Individual të Arsimit (PIA).

Megjithatë, auditimi konstatoi se, edhe pse praktika e ndjekur nga shumica e shkollave është e ngjashme, nuk ekziston një procedurë formale dhe e standardizuar për dokumentimin dhe referimin e nxënësve për vlerësim pedagogjik. Si rezultat, mënyra e referimit dhe dokumentimit të rasteve ndryshon ndërmjet shkollave. Për më tepër, u evidentua se nuk ekziston një dokument apo udhëzues i unifikuar për klasifikimin dhe përdorimin e diagnozave për nxënësit me NVA, i cili do të shërbente si referencë për profesionistët në shkolla dhe për EVK. Në mungesë të një standardi të tillë, identifikimi dhe kategorizimi i rasteve mbetet i paqëndrueshëm dhe i ekspozuar ndaj interpretimeve të ndryshme. Gjatë auditimit janë identifikuar raste kur në shkolla janë përdorur diagnoza si ankthi dhe depresioni për të klasifikuar nxënësit si fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, çka tregon mungesë të qartësisë në përcaktimin e kategorive të NVA dhe në përdorimin e terminologjisë profesionale dhe po ashtu, llojin e mbështetjes pedagogjike që duhet të ofrohet në këto raste.

Një faktor shtesë që ndikon në proces është roli i prindërve. Në disa raste, prindërit hezitojnë të kërkojnë vlerësim për fëmijët e tyre, për shkak të mungesës së informacionit mbi përfitimet e vlerësimit, frikës nga stigmatizimi dhe paragjyqimeve në komunitet. Procesi i referimit dhe vlerësimit pedagogjik realizohet vetëm me pëlqimin e prindit ose kujdestarit ligjor¹⁰. Në rastet kur ky pëlqim mungon, nxënësit vazhdojnë të ndjekin mësimin në klasat e rregullta pa një

¹⁰ Udhëzimin Administrativ nr. 16/2017 dhe ndryshimet e tij me UA nr. 02/2024

vlerësim të plotë të nevojave të tyre arsimore dhe pa përfituar mbështetjen e nevojshme pedagogjike.

Përveç Komunës së Prishtinës, janë analizuar edhe praktikat në komunat e Mitrovicës dhe Pejës për të vlerësuar nëse procesi i identifikimit dhe referimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore (NVA) është i standardizuar dhe i qëndrueshëm në nivel vendi.

Në Komunën e Mitrovicës u raportua se nuk ka një qasje të unifikuar për identifikimin e nxënësve me NVA, por procesi zhvillohet përmes udhëzimeve të përgjithshme dhe bashkëpunimit me shkollat dhe prindërit. Po ashtu, u theksua mungesa e një logopedi dhe kapacitetet e kufizuara profesionale, si dhe mungesa e qendrave burimore dhe shërbimeve mbështetëse, duke e bërë procesin më të varur nga praktikat individuale.

Në mënyrë të ngjashme, në Komunën e Pejës u raportua se identifikimi dhe referimi i nxënësve mbështetet kryesisht në raportimet e shkollave dhe nuk ekziston një mekanizëm i strukturuar dhe i standardizuar për menaxhimin e rasteve. Gjithashtu, u evidentua mungesa e koordinimit dhe e mekanizmave të qartë për monitorimin e procesit të identifikimit dhe referimit.

Mungesa e standardizimit në procesin e identifikimit dhe referimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore lidhet kryesisht me zbatimin jo të njëtrajtshëm të procedurave ekzistuese dhe mungesën e praktikave të standardizuara në nivel shkollor dhe komunal. Auditimi konstatoi se nuk përdoret një formular i unifikuar për identifikimin dhe referimin e rasteve, nuk janë përcaktuar afate të standardizuara për periudhën e vëzhgimit të nxënësve, nuk dokumentohen në mënyrë të njëtrajtshme vëzhgimet dhe komunikimi me prindërit, ndërsa dokumentacioni që i bashkëngjitet referimit për vlerësim pedagogjik ndryshon ndërmjet shkollave.

Megjithëse korniza ligjore dhe udhëzimet administrative përcaktojnë procedurat e vlerësimit pedagogjik nga Ekipi Vlerësues Komunal, faza paraprake e identifikimit fillestar dhe referimit të nxënësve nga shkollat nuk është e standardizuar mjaftueshëm. Në praktikë, kjo fazë mbështetet kryesisht në vëzhgimet dhe vlerësimet individuale të stafit shkollor. Në mungesë të procedurave të harmonizuara dhe monitorimit sistematik, shkollat dhe komunat kanë zhvilluar qasje të ndryshme në identifikimin dhe referimin e nxënësve me NVA, duke krijuar dallime në praktikë dhe në cilësinë e të dhënave të raportuara.

Si pasojë e këtyre mangësive, procesi i identifikimit dhe referimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore nuk siguron trajtim të barabartë dhe të qëndrueshëm për të gjithë nxënësit. Në veçanti, ekziston rreziku që nxënësit të mos identifikohen në kohë ose të mos referohen për vlerësim pedagogjik, kategorizimi i nxënësve mund të mos jetë i saktë, duke ndikuar në cilësinë e vlerësimit dhe në përcaktimin e mbështetjes së duhur. Për më tepër, një numër i nxënësve vazhdojnë të ndjekin mësimin në klasat e rregullta pa mbështetje të strukturuar pedagogjike dhe po krijohen dallime ndërmjet shkollave dhe komunave në mënyrën e trajtimit të rasteve.

Në fund, këto mangësi ndikojnë drejtpërdrejt në progresin akademik dhe zhvillimin e përgjithshëm të nxënësve me NVA, duke rritur rrezikun që ata të mbesin pas në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre dhe të mos përfitojnë nga një arsim gjithëpërfshirës në praktikë.

Kjo gjetje lidhet me fazën e parë të procesit, e cila zhvillohet në nivel shkolle dhe përfshin identifikimin, dokumentimin dhe referimin e nxënësve për vlerësim pedagogjik. Funkcionimi i fazës së dytë, përkatësisht realizimi i vlerësimit pedagogjik nga Ekipi Vlerësues Komunal, trajtohet në gjetjen në vijim.

3.1.2 Mosfunksionimi i Ekipit Vlerësues Komunal pengon zbatimin e procedurës së vlerësimit pedagogjik

Ekipet Vlerësuese Komunale duhet të jenë funksionale, të përbëra nga profilet profesionale të përcaktuara dhe të kryejnë vlerësimet dhe rivlerësimet pedagogjike në kohë, me qëllim që nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të identifikohen, vlerësohen dhe të përfitojnë mbështetjen e nevojshme pa vonesa¹¹. Procesi i vlerësimit pedagogjik duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i qasshëm për të gjithë nxënësit që referohen për vlerësim, ndërsa komunat duhet të sigurojnë funksionimin e pandërprerë të ekipeve vlerësuese dhe kapacitetet e nevojshme profesionale për realizimin e mandatit të tyre¹².

Pas referimit të nxënësit nga shkolla, procedura vazhdon me vlerësimin pedagogjik që realizohet nga Ekipi Vlerësues Komunal (EVK) i themeluar në kuadër të Drejtorisë Komunale të Arsimit. Ky ekip është multidisiplinar dhe përbëhet nga profesionistë të fushave të ndryshme, si zyrtari për arsim gjithëpërfshirës, psikologu, pedagogu special, logopedi, punëtori social dhe profesionistë të tjerë sipas nevojës.

Procesi i vlerësimit pedagogjik fillon me paraqitjen e kërkesës për vlerësim nga shkolla ose nga prindërit e fëmijës në Drejtorinë Komunale të Arsimit. Pas pranimit të kërkesës, rasti shqyrtohet nga Ekipi Vlerësues Komunal, i cili realizon vlerësimin e nevojave arsimore të fëmijës në bazë të dokumentacionit përkatës, vëzhgimeve profesionale dhe informacioneve të siguruar nga shkolla dhe prindërit.

Si rezultat i këtij procesi, ekipi vlerësues nxjerr rekomandime për mbështetjen pedagogjike të nxënësit në procesin mësimor. Këto rekomandime shërbejnë si bazë për hartimin e Planit Individual Arsimor (PIA) dhe për përcaktimin e formave të tjera të mbështetjes arsimore për nxënësin.

Me ndryshimet e fundit të udhëzimit administrativ në vitin 2024¹³, procesi administrativ i vlerësimit pedagogjik udhëhiqet nga zyrtari komunal për arsim gjithëpërfshirës, i cili

¹¹ UA nr. 02/2024 për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore

¹² Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-032) Neni 3 dhe 39

¹³ Udhëzimit Administrativ (MASHTI) Nr. 02/2024 për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve dhe Nxënësve me Nevoja të Veçanta Arsimore,

koordinon punën e ekipit vlerësues dhe menaxhon procedurat administrative të lidhura me vlerësimin e rasteve.



Figura 3 Procesi i vlerësimit pedagogjik

Megjithatë, në praktikë, ky proces nuk zhvillohet sipas këtij modeli në të gjitha komunat e audituara (Figura 4).

Në Komunën e Prishtinës, Ekipi Vlerësues Komunal nuk funksiononte me të gjitha profilet profesionale të nevojshme për realizimin e një vlerësimi të plotë multidisiplinar të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Roli i kryetarit ushtrohej nga zyrtari për arsim gjithëpërfshirës në vend të pedagogut special, si dhe mungonte profili i logopedit. Pavarësisht kësaj, ekipi ka vazhduar të funksionojë deri në tetor 2025, kur pas gjetjeve të auditimit të brendshëm të DKA

është ndërprerë funksionimi i tij. Si rezultat, EVK nuk ka qenë funksional nga tetori 2025 deri në fund të shkurtit 2026, periudhë kjo gjatë së cilës është realizuar edhe puna në terren.

Kjo ndërprerje përkon me një periudhë veçanërisht kritike të vitit shkollor, kur zakonisht evidentohet rritje e kërkesave për vlerësim të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, për shkak të fillimit të vitit të ri shkollor dhe identifikimit të rasteve të reja nga shkollat. Si rezultat, mungesa e funksionimit të Komisionit ka ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e pritjeve për vlerësim dhe në vonesa në trajtimin e rasteve, duke kufizuar qasjen në mbështetje të duhur për nxënësit.

Sipas shpjegimeve të ofruara nga DKA, kjo situatë lidhet me mungesën e kuadrove profesionale përkatëse në nivel komunal, konkretisht të profileve si pedagog special dhe logoped. Megjithatë, ndërprerja e funksionimit të një mekanizmi kyç si EVK, në mungesë të zgjidhjeve alternative apo masave tranzitore, tregon për dobësi në menaxhimin institucional dhe në sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Kjo situatë reflektohet edhe në të dhënat e mbledhura në nivel shkollash, ku një numër i konsiderueshëm i nxënësve mbeten të pavlerësuar ose në pritje për vlerësim nga EVK.

Në Komunën e Pejës, ndonëse ekziston vendimi për themelimin e EVK, përbërja e tij nuk është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, pasi ekipi funksionon pa profilin e logopedit. Për më tepër, kapacitetet janë të kufizuara dhe funksionimi i ekipit nuk është i mjaftueshëm për të përballuar kërkesat për vlerësim, duke rezultuar në ritëm të ulët të trajtimit të rasteve dhe krijim të pritjeve.

Në Komunën e Mitrovicës, , EVK nuk ka qenë funksional që nga shtatori 2025. Gjithashtu, kjo komunë nuk ka pasur asnjëherë zyrtar për arsim gjithëpërfshirës, pavarësisht se për këtë pozitë është ndarë buxhet nga niveli qendror. Sipas të dhënave, komuna nuk ka hapur konkurs për këtë pozitë, por për pozita të tjera. Një ndër arsyt kryesore për mosfunksionimin e EVK është raportuar të jetë mënyra e kompensimit të anëtarëve të ekipit, të cilët kompensohen vetëm për punë gjatë vikendeve ose jashtë orarit të rregullt të punës, çka nuk ka qenë e mjaftueshme për të siguruar angazhimin e tyre.

Komuna	Statusi i EVK	Perioda e mosfunksionimit	Mangësitë kryesore (të identifikuara)	Arsyeja kryesore e mosfunksionimit / mangësive	Raste në pritje për vlerësim / rivlerësim
 Prishtinë	 Jo funksionale	 Tetor 2025 – Shkurt 2026	- Mungesë e logopedit - Përbërje jo e plotë profesionale	Ndërprerja e funksionimit pas gjetjeve të auditimit të brendshëm dhe mungesa e mekanizmave për vazhdimësi të punës.	100+ raste në pritje 
 Mitrovicë	 Jo funksionale	 Nga shtatori 2025	- Mungesë e logopedit - Ekip jo i plotë profesional	Mosangazhimi i anëtarëve të EVK për shkak të mungesës së kompensimit financiar.	30 raste në pritje 
 Pejë	 Pjesërisht funksionale	 Nuk ka	Mungesë e logopedit	EVK ka vazhduar punën pavarësisht mungesës së logopedit.	27 raste në pritje 

Figura 4 Statusi i funksionimit të Ekipeve Vlerësuese Komunale (EVK) në komunat e audituara

Udhëzimi Administrativ¹⁴ përcakton që DKA-të të raportojnë çdo gjashtë muaj në MASHTI për funksionimin e Ekipeve Vlerësuese Komunale dhe procesin e vlerësimit pedagogjik. Megjithatë, gjatë auditimit nuk janë evidentuar dëshmi se ky raportim është realizuar rregullisht dhe në mënyrë të njëtrajtshme nga të tri komunat e audituara. Informatat janë siguruar kryesisht pas kërkesave specifike, ndërsa auditimit nuk i janë ofruar raporte të plota periodike apo analiza të konsoliduara që dëshmojnë se të dhënat mbi funksionimin e EVK-ve, numrin e rasteve të trajtuara dhe listat e pritjes janë monitoruar sistematikisht në nivel qendror. Këto gjetje tregojnë se sfidat në funksionimin e EVK nuk janë të izoluara, por paraqesin një problem sistematik në zbatimin e procedurës së vlerësimit pedagogjik në tri komunat e audituara.

Shkaqet kryesore të kësaj situate lidhen me mungesën e kuadrove profesionale përkatëse (pedagog special dhe logoped), mosplotësimin e pozitive kyçe si zyrtari për arsim gjithëpërfshirës, si dhe dobësitë në menaxhimin institucional dhe në planifikimin e burimeve njerëzore në nivel komunal. Po ashtu, mënyra e organizimit të punës dhe e kompensimit të anëtarëve të EVK nuk është e përshtatshme për të siguruar funksionim të qëndrueshëm të ekipit. Mungesa e mekanizmave të qartë për monitorim nga MASHTI kontribuon më tej në mos identifikimin në kohë të këtyre problemeve dhe në mungesën e ndërhyrjeve korrigjuese.

Si pasojë, një numër i konsiderueshëm i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore mbeten pa vlerësim pedagogjik ose përballen me vonesa të gjata në këtë proces. Kjo ndikon drejtpërdrejt në vonesat në hartimin e Planeve Individuale të Arsimit (PIA) dhe në sigurimin e mbështetjes së duhur pedagogjike, duke kufizuar përfshirjen efektive të këtyre nxënësve në procesin mësimor dhe duke rritur rrezikun e përjashtimit funksional nga sistemi arsimor.

¹⁴ Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2024 për Vlerësimin Pedagogjik

3.1.2.1 Ndikimi i mosfunksionimit të Ekipeve Vlerësuese Komunale në vonesa të vlerësimit pedagogjik dhe listat e pritjes

Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore duhet të kenë qasje në vlerësim pedagogjik në kohë, pasi rezultatet e vlerësimit përbëjnë bazën për planifikimin e mbështetjes arsimore, hartimin e Planeve Individuale të Arsimit (PIA) dhe përcaktimin e shërbimeve mbështetëse. Për këtë qëllim, Ekipet Vlerësuese Komunale duhet të jenë funksionale dhe të trajtojnë kërkesat për vlerësim dhe rivlerësim pa vonesa të panevojshme¹⁵.

Vlerësimi pedagogjik i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore realizohet nga Ekipi Vlerësues Komunal (EVK) në kuadër të DKA. Ky vlerësim ka për qëllim identifikimin e nevojave arsimore të nxënësit dhe dhënien e rekomandimeve profesionale për mbështetjen e tij në procesin mësimor. Rezultatet e këtij vlerësimi përbëjnë bazën për planifikimin e mbështetjes arsimore, përfshirë hartimin e PIA dhe përcaktimin e formave të tjera të mbështetjes pedagogjike.

Megjithatë, analiza e të dhënave të mbledhura në shkollat e përzgjedhura në tri komunat tregon se një pjesë e nxënësve të identifikuar me nevoja të veçanta arsimore nuk kanë kaluar procesin e vlerësimit pedagogjik nga EVK.

Nga gjithsej 181 nxënës me NVA të identifikuar në shkollat e përzgjedhura në mostër, 120 nxënës janë vlerësuar nga EVK, ndërsa 61 nxënës nuk kanë kaluar këtë proces. Kjo nënkupton se rreth një e treta e nxënësve me NVA nuk janë vlerësuar, duke krijuar një boshllëk të konsiderueshëm ndërmjet identifikimit dhe vlerësimit.

Duhet theksuar se të dhënat e paraqitura më poshtë përfshijnë të gjitha vlerësimet pedagogjike të realizuara për nxënësit në mostër para ndërprerjes së funksionimit të Ekipeve Vlerësuese Komunale në Prishtinë (shtator 2025) dhe Mitrovicë (tetor 2025). Për këtë arsye, një pjesë e nxënësve në mostër posedojnë vlerësime pedagogjike të realizuara para kësaj periudhe.

Në Komunën e Prishtinës, nga gjithsej 124 nxënës me NVA në mostër, vetëm 67 nxënës janë vlerësuar nga EVK, ndërsa 57 nxënës nuk kanë kaluar këtë proces. Kjo nënkupton se rreth 46% e nxënësve me NVA nuk janë vlerësuar, ndërsa vetëm 54% kanë kaluar procesin formal të vlerësimit pedagogjik. Në Komunën e Pejës, situata paraqitet më e favorshme, ku nga gjithsej 29 nxënës me NVA në mostër, 25 nxënës janë vlerësuar, ndërsa 4 nxënës nuk kanë kaluar procesin e vlerësimit pedagogjik. Në Komunën e Mitrovicës, të gjithë 28 nxënësit me NVA të identifikuar në shkollat e përzgjedhura janë vlerësuar nga EVK.

¹⁵ Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës; UA nr. 02/2024 për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore; Strategjia e Arsimit 2022–2026.

Tabela 4 Statusi i vlerësimit sipas komunave për vitin 2025

Komuna	Nxënës me NVA	Vlerësuar nga EVK	Pa vlerësim
Prishtinë	124	67	57
Mitrovicë	28	28	0
Pejë	29	25	4
Gjithsej	181	120	61

Analiza e të dhënave sipas shkollave në Komunën e Prishtinës tregon dallime të konsiderueshme në përqindjen e nxënësve të vlerësuar. Në Komunën e Prishtinës, në shkollën “Emin Duraku”, të gjithë nxënësit me NVA kanë kaluar procesin e vlerësimit pedagogjik. Në të kundërt, situata paraqitet veçanërisht problematike në shkollën “Meto Bajraktari”, ku nga 33 nxënës me NVA, vetëm 9 janë vlerësuar, ndërsa 24 nxënës (rreth 73%) nuk kanë kaluar procesin e vlerësimit.

Këto dallime tregojnë se procesi i vlerësimit pedagogjik nuk zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme ndërmjet shkollave dhe komunave, duke reflektuar kapacitete dhe praktika të ndryshme në nivel komunal.

Përveç nxënësve që nuk janë vlerësuar ende, një pjesë e nxënësve janë aktualisht në pritje për vlerësim pedagogjik nga EVK.

Në Komunën e Prishtinës, në mostër janë identifikuar gjithsej 23 nxënës në pritje për vlerësim. Sipas të dhënave nga DKA, lista e pritjes në nivel komune është edhe më e lartë, ku mbi 100 nxënës janë në pritje për vlerësim pedagogjik.

Në Komunën e Pejës, në shkollat e përzgjedhura është identifikuar të paktën 1 nxënës në pritje për vlerësim. Megjithatë, sipas dokumentacionit të siguruar nga DKA Pejë, lista e pritjes në nivel komune përfshin gjithsej 27 nxënës, duke përfshirë si raste për vlerësim fillestar ashtu edhe për rivlerësim. Kjo tregon se, pavarësisht se në mostër situata paraqitet më e kufizuar, në nivel komune ekziston një numër më i madh i rasteve që presin trajtim nga EVK.

Në Komunën e Mitrovicës, në mostër janë identifikuar gjithsej 5 nxënës në pritje për vlerësim pedagogjik. Megjithatë, sipas informacioneve të siguruar nga DKA Mitrovicë, numri i

nxënësve në pritje për vlerësim në nivel komune është mbi 30 raste, e që tregon se situata reale është më e theksuar sesa ajo e reflektuar në mostër.

Tabela 5 Nxënësit në pritje për vlerësim bazuar ne Komuna

Komuna	Nxënës në pritje (mostra)	Nxënës në pritje (në gjithë komunën)
 Prishtinë	23	>100
 Mitrovicë	1	27
 Pejë	3	>30
 Gjithsej	29	-

Këto të dhëna tregojnë se lista e pritjes për vlerësim pedagogjik është e pranishme në të gjitha komunat e analizuara dhe nuk kufizohet vetëm në rastet e identifikuara në mostër. Në të gjitha rastet, numri i nxënësve në pritje në nivel komune është më i lartë sesa ai i reflektuar në mostër, duke treguar për një ngarkesë më të madhe të sistemit sesa ajo që shihet në nivel të shkollave të përzgjedhura.

Prania e rasteve për rivlerësim në listën e pritjes tregon gjithashtu se sistemi nuk po arrin të përmbushë në kohë jo vetëm kërkesat për vlerësim fillestar, por edhe nevojën për rishikim të vazhdueshëm të rasteve ekzistuese.

Përtej të dhënave statistikore, gjatë auditimit janë evidentuar edhe raste konkrete që ilustrojnë ndikimin e drejtpërdrejtë të këtyre mangësive në praktikë. Në një nga shkollat e Komunës së Mitrovicës është raportuar se gjatë vitit 2025 nuk është realizuar asnjë vlerësim apo rivlerësim i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, përkundër kërkesave të vazhdueshme të shkollës, për shkak se Ekipi Vlerësues Komunal nuk ka qenë i themeluar dhe për rrjedhojë nuk ka qenë funksional gjatë kësaj periudhe. Si pasojë, nxënësit që kanë qenë në proces të identifikimit kanë mbetur pa kaluar vlerësimin pedagogjik dhe nuk kanë përfituar nga hartimi i Planit Individual të Arsimit, duke u ofruar vetëm mbështetje e përgjithshme nga shkolla, pa një bazë të strukturuar dhe të standardizuar.

Mospërfshirja e të gjithë nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në procesin e vlerësimit pedagogjik dhe krijimi i listave të pritjes lidhen me dobësi në funksionimin e mekanizmit të vlerësimit në nivel komunal dhe në menaxhimin e këtij procesi në nivel institucional. Kapacitetet e kufizuara profesionale dhe organizative, mungesa e vazhdimësisë në funksionimin e EVK dhe mungesa e mekanizmave efektivë për monitorim dhe raportim kanë

bërë që sistemi të mos jetë në gjendje të përballojë kërkesat në rritje për vlerësim të nxënësve me NVA.

Si pasojë, një numër i konsiderueshëm i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore përballen me vonesa të gjata në vlerësim, të cilat në disa raste mund të zgjasin një vit ose më shumë. Duke qenë se në disa komuna EVK nuk ka qenë funksional që nga fillimi i vitit shkollor (shtator-tetor 2025), kërkesat për vlerësim janë grumbulluar dhe janë shtuar mbi listat ekzistuese të pritjes nga vitet paraprake. Si rrjedhojë, nxënësit e identifikuar rishtazi nuk trajtohen menjëherë, por hyjnë në një radhë pritjeje ku përparësi kanë rastet e mbetura nga periudhat e mëparshme.

Në këto kushte, një pjesë e nxënësve mund të kalojnë një periudhë të gjatë, përfshirë një vit të plotë shkollor, pa u vlerësuar dhe pa përfituar mbështetje të strukturuar pedagogjike. Në mungesë të vlerësimit pedagogjik, këta nxënës ndjekin procesin mësimor pa një kuptim të qartë të nevojave të tyre arsimore dhe pa ndërhyrje të përshtatura për zhvillimin e tyre. Si rezultat, vonohet hartimi i Planeve Individuale të Arsimit dhe kufizohet mundësia për mbështetje efektive në klasë, duke ndikuar drejtpërdrejt në progresin e tyre akademik dhe në zhvillimin e përgjithshëm. Kjo situatë rrit rrezikun e përjashtimit funksional të nxënësve me NVA nga sistemi arsimor, pavarësisht se janë të përfshirë formalisht në të.

3.2 Planifikim Mbështetja pedagogjike – (PIA dhe mësimdhënia e diferencuar)

Ky kapitull trajton planifikimin dhe zbatimin e mbështetjes pedagogjike për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA), duke u fokusuar në procesin e hartimit, dokumentimit dhe rishikimit të Planeve Individuale të Arsimit (PIA), si dhe në mënyrën se si ato zbatohen në praktikë. Po ashtu, auditimi vlerëson nëse mbështetja pedagogjike planifikohet në përputhje me nevojat individuale të nxënësve dhe nëse procesi mbështetet nga dokumentacion i plotë, monitorim i rregullt dhe bashkëpunim ndërmjet shkollës, prindërve dhe stafit profesional.

3.2.1 Planet Individuale Arsimore nuk hartohen dhe rishikohen në mënyrë të standardizuar

Për çdo nxënës të vlerësuar me nevoja të veçanta arsimore duhet të hartohet dhe zbatohet Plani Individual i Arsimit (PIA), i cili duhet të përmbajë objektiva të qarta dhe të matshme, masa konkrete mbështetëse, përgjegjësit për zbatimin e tyre dhe afatet për monitorim dhe rishikim periodik¹⁶.

PIA duhet të hartohet dhe dokumentohet në mënyrë të standardizuar, me pjesëmarrjen e mësimdhënësve, stafit profesional dhe prindërve, ndërsa progresi i nxënësit duhet të monitorohet dhe të

¹⁶ Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës; Udhëzimi Administrativ për Planin Individual të Arsimit (PIA)

reflektohet në rishikimet periodike të planit. Procesi i hartimit, zbatimit dhe rivlerësimit të PIA-së duhet të sigurojë që mbështetja pedagogjike të përshtatet vazhdimisht me nevojat dhe zhvillimin e nxënësit¹⁷.

Gjendja në nivel të shkollave dhe komunave sa i përket ofrimit të shërbimeve mbështetëse për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA) nuk paraqitet e kënaqshme. Numri i nxënësve me NVA është dukshëm më i lartë krahasuar me numrin e asistentëve, mësuesve mbështetës dhe stafit profesional të angazhuar në shkolla.

Për më tepër, në disa shkolla është evidentuar mungesa e psikologëve dhe pedagogëve, të cilët kanë rol kyç jo vetëm në mbështetjen e nxënësve me NVA, por edhe në ofrimin e mbështetjes psiko-sociale dhe pedagogjike për nxënësit në përgjithësi.

Plani Individual i Arsimit (PIA) është dokumenti kryesor pedagogjik për planifikimin e mbështetjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Ai hartohet mbi bazën e rekomandimeve të vlerësimit pedagogjik dhe përcakton objektivat individuale të të nxënës, metodat dhe format e mbështetjes, përgjegjësit për zbatimin e tyre, si dhe mënyrën dhe afatet për monitorimin dhe rivlerësimin e progresit të nxënësit. Përmes PIA-së synohet që procesi mësimor të përshtatet me nevojat dhe potencialin individual të secilit nxënës.

Analiza e mostrave të përzgjedhura në shkollat e audituara tregon se në shumicën e rasteve nxënësit e vlerësuar nga ekipet komunale posedojnë PIA aktive dhe të strukturuar sipas formularëve standardë të MASHTI-t. Në PIA-të e analizuar janë evidentuar objektiva të matshme, indikatorë të progresit dhe përfshirje e stafit pedagogjik dhe profesional në hartimin e tyre.

Në disa raste janë evidentuar praktika relativisht të mira të dokumentimit dhe koordinimit multidisiplinar. Në SHFMU “Hasan Prishtina” dhe “Ismail Qemali” janë evidentuar raporte javore të punës së mësuesve mbështetës, koordinim me psikologun, prindërit, asistentët dhe shërbime të jashtme si logopedë dhe qendra mbështetëse. Gjithashtu janë evidentuar plane vjetore të psikologëve që përfshijnë aktivitete për rishikimin e PIA-ve, këshillim individual dhe bashkëpunim me mësimdhënësit dhe prindërit.

Po ashtu, në këto dhe shkollat e tjera të përfshira në mostër janë evidentuar nxënës me nevoja të veçanta arsimore (NVA) të cilët, ndonëse janë identifikuar nga shkolla si raste me nevojë për mbështetje pedagogjike, nuk kanë kaluar procesin formal të vlerësimit komunal dhe rrjedhimisht nuk posedojnë PIA aktive.

Megjithatë, auditimi konstatoi se procesi i hartimit, dokumentimit dhe rishikimit të PIA-ve nuk zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha shkollat. Në disa raste, nxënës të vlerësuar me nevoja të veçanta arsimore nuk posedonin PIA aktive, ndonëse mbështetja pedagogjike

¹⁷ Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Kosovës (KKK); Udhëzuesi për Hartimin dhe Zbatimin e PIA-së (MASHTI); Strategjia e Arsimit 2022–2026.

ishte rekomanduar. Në raste të tjera, PIA-të ishin hartuar pa dokumentacion të plotë mbështetës, mungonte raporti i vlerësimit pedagogjik në dosjen e nxënësit, nuk ishin nënshkruar nga të gjithë anëtarët përgjegjës ose nuk përmbanin datat e vlerësimit dhe të rishikimit periodik. Si rezultat, nuk mund të sigurohej gjurmueshmëria e plotë e procesit dhe as të vlerësohej nëse mbështetja pedagogjike ishte planifikuar dhe rishikuar në përputhje me nevojat e nxënësit.

Tabela 6 PIA-të aktive në mostrat e përzgjedhura në tri komunat

 Shkolla	 Mostrat e analizuar	 PIA Aktive	 Vlerësim Komunal	 Rivlerësim
Ismail Qemali	13	10	12	0
Hasan Prishtina	10	9	9	0
Emin Duraku	9	1	9	0
Meto Bajraktari	7	6	7	0
Dituria	Raste të viteve paraprake	1/4	2/4	1/4
Andon Z. Çajupi	5	5	2	0
Migjeni	4	4	0	0
Abdullah Shabani	1	0	1	0
Ramiz Sadiku	8	8	7	2
Asdreni	8	2	5	1

Analiza e mostrave të PIA-ve në shkollat e përzgjedhura ka treguar dallime të konsiderueshme ndërmjet shkollave në hartimin, dokumentimin dhe rishikimin e tyre. Në disa shkolla, shumica e nxënësve të analizuar posedonin PIA aktive dhe dokumentacioni ishte relativisht më i strukturuar, ndërsa në shkolla të tjera janë evidentuar raste kur nxënës të vlerësuar me NVA nuk posedonin PIA aktive, ose PIA-të ishin hartuar pa dokumentacion të plotë mbështetës.

Mangësitë më të shpeshta të evidentuara lidhen me mungesën e kërkesave formale për vlerësim, mungesën e raporteve të vlerësimit pedagogjik në dosje, mungesën e nënshkrimeve të anëtarëve përgjegjës, mungesën e datave të vlerësimit apo rishikimit, si dhe mungesën e dokumentimit të diagnozës ose bazës së kategorizimit të nxënësit. Po ashtu, në disa raste janë evidentuar PIA të hartuara për nxënës që nuk kishin kaluar ende procesin formal të vlerësimit pedagogjik, ndërsa në raste të tjera nxënës të vlerësuar nuk posedonin PIA aktive.

Auditimi ka evidentuar edhe praktika pozitive në disa shkolla, përfshirë dokumentim më të strukturuar, bashkëpunim me prindërit, përfshirje të stafit profesional dhe rishikim më të rregullt të PIA-ve. Megjithatë, këto praktika nuk janë të njëtrajtshme në të gjitha shkollat dhe varen kryesisht nga organizimi i brendshëm, kapacitetet profesionale dhe angazhimi i stafit shkollor.

Përmbledhja e detajuar e analizës së mostrave të PIA-ve sipas shkollave është paraqitur në Shtojcën 3.

Në përgjithësi, nga analiza më e detajuar e mostrave të PIA-ve është evidentuar se shumica e tyre përmbajnë objektiva pedagogjike konkrete dhe të përshtatura sipas nevojave individuale të nxënësve. Këto objektiva lidhen kryesisht me zhvillimin e komunikimit verbal dhe joverbal, përmirësimin e përqendrimit gjatë orës mësimore, zhvillimin e shkathtësive sociale, rritjen e pavarësisë në kryerjen e aktiviteteve të përditshme, si dhe përmirësimin e shkathtësive akademike bazë si leximi, shkrimi dhe operacionet elementare matematikore. Në disa PIA janë përcaktuar edhe metoda konkrete të punës pedagogjike dhe mbështetëse, si:

- përdorimi i materialeve vizuale dhe ilustrative;
- përsëritja e udhëzimeve në hapa të thjeshtë;
- puna individuale me nxënësin;
- përdorimi i kartelave komunikuese;
- angazhimi i aktiviteteve praktike dhe motorike;
- pushime të shkurtra gjatë procesit mësimor për ruajtjen e përqendrimit;
- si dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm ndërmjet mësuesit, psikologut, prindit dhe asistentit.

Po ashtu, në shumicën e PIA-ve janë evidentuar indikatorë ose forma të monitorimit të progresit të nxënësit, si:

- “arrin të ndjekë udhëzimet me ndihmë minimale”;
- “përmirëson komunikimin me bashkëmoshatarët”;
- “qëndron i përqendruar për periudha më të gjata”;
- “realizon aktivitetet bazë me mbështetje të pjesshme”;
- apo “arrin të identifikojë shkronjat dhe numrat bazë”.

Nga analiza e PIA-ve nuk janë evidentuar raste ku planet individuale të arsimit të ishin identike për nxënësit të ndryshëm. Edhe pse përdoret formular standard, përmbajtja pedagogjike në shumicën e rasteve është e individualizuar dhe reflekton gjendjen dhe nevojat specifike të nxënësve. Për shembull, në disa raste fokusi i PIA-së ishte zhvillimi i komunikimit dhe socializimit, ndërsa në raste të tjera fokusi ishte kryesisht akademik apo funksional, varësisht nga niveli dhe nevojat e nxënësit.

Në disa raste, në PIA nuk ishte evidentuar diagnoza e nxënësit apo dokumentacioni mbështetës mbi bazën e kategorizimit të tij, gjë që e vështirësonte ndërlidhjen e objektivave pedagogjike me nevojat specifike dhe mbështetjen e nevojshme për nxënësin.

Gjithashtu, ndonëse formularët e PIA-ve përmbajnë seksione për rishikim dhe rivlerësim periodik, auditimi ka evidentuar se në praktikë rivlerësimi pothuajse nuk realizohet edhe pas kalimit të afatit ligjor dyvjeçar. Për pasojë, në shumë raste objektivat dhe mbështetja

pedagogjike nuk përditësohen në përputhje me progresin apo ndryshimet në nevojat e nxënësve me NVA.

Kjo situatë lidhet me mungesën e monitorimit të rregullt nga shkollat, DKA-të dhe MASHTI mbi cilësinë, zbatimin dhe rishikimin e PIA-ve, si dhe me mungesën e praktikave të standardizuara për ruajtjen e dokumentacionit, nënshkrimin, përditësimin dhe ndjekjen e progresit të nxënësve. Po ashtu, vonesat në vlerësim dhe rivlerësim nga EVK ndikojnë në përditësimin e PIA-ve dhe në përshtatjen e mbështetjes pedagogjike.

Si pasojë, PIA nuk funksionon në të gjitha rastet si instrument i plotë dhe i përditësuar për planifikimin dhe monitorimin e mbështetjes individuale. Kur PIA mungon, nuk dokumentohet si duhet ose nuk rishikohet në kohë, mbështetja pedagogjike rrezikon të mbetet e përgjithshme, jo e përshtatur dhe jo e lidhur mjaftueshëm me progresin dhe nevojat reale të nxënësit.

3.2.2 Mësimdhënia e diferencuar në praktikë

Mësimdhënia për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore duhet të përshtatet me nevojat individuale të secilit nxënës përmes aplikimit të metodave të mësimdhënies së diferencuar, përdorimit të materialeve didaktike të përshtatura, metodave alternative të komunikimit dhe organizimit të mjedisit mësimor gjithëpërfshirës. Mbështetja pedagogjike duhet të zbatohet në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha shkollat dhe të mos varet nga iniciativa individuale e mësimdhënësve apo mbështetja e donatorëve¹⁸.

Mbështetja pedagogjike për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nuk kufizohet vetëm në hartimin formal të Planeve Individuale të Arsimit (PIA), por duhet të reflektohet edhe në praktikën e përditshme mësimore përmes mësimdhënies së diferencuar¹⁹ dhe përshtatjes së aktiviteteve sipas nevojave individuale të nxënësve.

Literatura dhe raportet relevante në fushën e arsimit gjithëpërfshirës theksojnë se mësimdhënia tradicionale, e bazuar në të njëjtat metoda, ritëm dhe forma vlerësimi për të gjithë nxënësit, nuk arrin t'u përgjigjet nevojave të klasave heterogjene²⁰ dhe nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Sipas studimeve mbi mësimdhënien e diferencuar, në mësimdhënien tradicionale dallimet individuale shpesh mbeten të paadresuara, ndërsa fokusi kryesor mbetet zhvillimi uniform i mësimit për të gjithë klasën. Në kontrast me këtë qasje,

¹⁸ Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar në Kosovë, UNESCO – Guidelines for Inclusion and Equity in Education, UNICEF – Child Protection Index

¹⁹ Mësimdhënia e diferencuar nënkupton përshtatjen e metodave, aktiviteteve, materialeve dhe mënyrës së organizimit të orës mësimore sipas aftësive dhe nevojave të nxënësve gjatë procesit mësimor. Ndërsa qasja e dizajnit universal për të mësuar synon që vetë kurrikula dhe mjedisi mësimor të ndërtohen që në fillim në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qasshme për të gjithë nxënësit

²⁰ Klasat heterogjene janë mjedise mësimore ku nxënësit ndryshojnë nga njëri-tjetri në aftësitë, shpejtësinë e të nxënit, prejardhja sociale, motivimi dhe stilet e të menduarit

mësimdhënia e diferencuar bazohet në përshtatjen aktive të metodave, materialeve dhe aktiviteteve sipas nevojave, ritmit të të nxënësve dhe aftësive individuale të nxënësve.

Po ashtu, raportet ndërkombëtare dhe analizat për Kosovën evidentojnë se përdorimi i metodologjive gjithëpërfshirëse dhe të orientuara tek nxënësi mbetet ende i kufizuar në praktikë. Analizat ndërkombëtare tregojnë se përdorimi i metodave të mësimdhënies së orientuar tek nxënësi dhe zbatimi i qasjeve gjithëpërfshirëse në shkollat vazhdojnë të përballen me sfida që lidhen me kapacitetet profesionale të mësimdhënësve. Mësimdhënia gjithëpërfshirëse kërkon staf të trajnuar, resurse adekuate dhe mbështetje të vazhdueshme profesionale, pasi në mungesë të tyre shkollat hasin vështirësi në zbatimin praktik të metodologjive gjithëpërfshirëse dhe në përfshirjen efektive të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në procesin mësimor²¹. Në praktikë, mësimdhënia e diferencuar realizohet përmes:

- përdorimit të materialeve vizuale dhe didaktike;
- përshtatjes së detyrave dhe aktiviteteve;
- punës individuale ose në grupe të vogla;
- përdorimit të metodave alternative të komunikimit;
- si dhe krijimit të hapësirave dhe aktiviteteve mbështetëse për zhvillimin emocional, social dhe funksional të nxënësve me NVA.

Gjatë vëzhgimeve në terren është konstatuar se këto hapësira përdoren jo vetëm për aktivitete mësimore dhe mbështetje individuale, por edhe si ambiente qetësuese dhe mbështetëse për nxënësit që përjetojnë vështirësi emocionale, shqetësime apo vështirësi në përshtatje gjatë procesit mësimor në klasë. Në disa raste, nxënësit përdornin klasat burimore si hapësira alternative për stabilizim emocional dhe rikthim gradual në aktivitetet mësimore.

Auditimi ka identifikuar edhe praktika të mira të mbështetjes pedagogjike dhe mësimdhënies së diferencuar në disa nga shkollat e përzgjedhura. Shumica e shkollave të vizituara posedonin klasa burimore të pajisura me mjete didaktike dhe materiale mbështetëse për zhvillimin, qetësimin dhe mbështetjen individuale të nxënësve me NVA. Klasa burimore janë evidentuar në shumicën e shkollave të vizituara, përkatësisht në 4 nga 5 shkollat në Prishtinë (80%), në të dy shkollat e vizituara në Pejë (100%) dhe në 2 nga 3 shkollat në Mitrovicë (67%).

²¹ UNICEF Kosovo, *Situation Analysis of Children with Disabilities in Kosovo; Child Protection Index, Country Profile*
– Kosovo



Figura 5 Pamje nga klasa burimore SHFMU "Emin Duraku"



Figura 6 Pamje nga klasa burimore, SHFMU "Ramiz Sadiku" Peje

Po ashtu, në disa shkolla janë evidentuar praktika të mira të përdorimit të metodave alternative të komunikimit dhe materialeve të përshtatura didaktike. Në SHFMU “Ramiz Sadiku” është evidentuar përdorimi i metodës PECS²² (Sistemi i Komunikimit përmes Shkëmbimit të Figurave), të përfutur përmes trajnimeve nga organizata “Save the Children”,

²² Picture Exchange Communication System

si dhe zhvillimi i materialeve didaktike vetanake nga ekipi gjithëpërfshirës i shkollës. Në disa raste, mësime të përbashkëta dhe stafi profesional kishin krijuar materiale të personalizuar për nxënësit me NVA, përfshirë kartela komunikuese, ushtrime praktike, materiale vizuale dhe aktivitete motorike, në mënyrë që procesi mësimor të ishte më i kuptueshëm dhe më funksional për nxënësit.

Megjithatë, auditimi ka evidentuar se këto praktika mbeten të kufizuara dhe jo të standardizuara në nivel të sistemit arsimor. Në shumicën e rasteve, sigurimi i materialeve didaktike, pajisjeve mbështetëse dhe aktiviteteve alternative varet kryesisht nga iniciativa individuale e shkollave, mësime të përbashkëta apo mbështetja e organizatave joqeveritare dhe donatorëve të jashtëm, e jo nga planifikimi sistematik institucional apo financimi i rregullt nga MASHTI dhe DKA-të.

Në shumë shkolla është evidentuar mungesë e materialeve të specializuara dhe pajisjeve të përshtatura sipas diagnozave dhe nevojave specifike të nxënësve me NVA. Përkundër ekzistencës së klasave burimore, iveli i pajisjes së klasave burimore ndryshonte ndërmjet shkollave. Në disa raste, klasat burimore ishin të pajisura me materiale të ndryshme didaktike dhe mjete mbështetëse, ndërsa në raste të tjera ato përmbanin kryesisht materiale bazike, duke kufizuar mundësinë për përdorimin e metodave të ndryshme të mbështetjes pedagogjike.

Po ashtu, auditimi ka evidentuar se niveli i zbatimit të mësime të diferencuara dhe mbështetjes pedagogjike ndryshon dukshëm ndërmjet shkollave dhe varet kryesisht nga kapacitetet individuale të stafit, angazhimi i shkollës dhe disponueshmëria e resurseve mbështetëse. Në disa raste mungesa e stafit mbështetës dhe ngarkesa e lartë e mësime të përbashkëta kufizon mundësinë për zbatim të vazhdueshëm dhe të individualizuar të mbështetjes pedagogjike për nxënësit me NVA.

Nga pyetësorët me prindërit e nxënësve me NVA (Shtojca II) është evidentuar nevoja për mbështetje më të individualizuar dhe më funksionale në procesin mësimor. Prindërit kanë theksuar nevojën për metoda më praktike dhe më fleksibile të mësime të përbashkëta, përfshirë aktivitete laboratorike, mësim në natyrë, aktivitete muzikore dhe metoda interaktive, në mënyrë që nxënësit me NVA të ndihen më të përfshirë dhe të barabartë në procesin mësimor.

Një prind i një nxënëseje me NVA ka theksuar se, përkundër progresit të arritur në pavarësimin e fëmijës, mbështetja aktuale mbetet e kufizuar kryesisht në aspektin akademik, ndërsa nevojat për integrim social, zhvillim emocional dhe stimulim praktik mbeten të pamjaftueshme. Sipas prindit, nxënësi kishte nevojë për mbështetje më të madhe në socializim dhe integrim në aktivitetet shkollore, veçanërisht gjatë pushimeve dhe aktiviteteve grupore, si dhe për aktivitete shtesë fizike dhe praktike që do të ndikonin në përmirësimin e koncentrit, koordinimit dhe zhvillimit të aftësive funksionale.

Po ashtu, është theksuar nevoja për bashkëpunim më të madh ndërmjet psikologut, mësuesve mbështetës dhe mësime të përbashkëta të lëndorë, sidomos gjatë kalimit të nxënësve nga cikli klasor

në mësimin lëndor, ku nxënësit me NVA përballen me vështirësi më të mëdha në përshtatje dhe organizim.

Kjo situatë lidhet me mungesën e një planifikimi sistematik për sigurimin e materialeve didaktike dhe mjeteve mbështetëse, kapacitetet e kufizuara profesionale të stafit, mungesën e trajnimeve të vazhdueshme për mësimdhënie të diferencuar dhe mungesën e financimit të dedikuar për zhvillimin e praktikave gjithëpërfshirëse në shkolla. Si rezultat, zhvillimi i këtyre praktikave varet kryesisht nga angazhimi individual i shkollave dhe mbështetja e organizatave donatore.

Si pasojë, nxënësit me NVA nuk përfitojnë në mënyrë të barabartë nga mbështetja pedagogjike në të gjitha shkollat. Dallimet në disponueshmërinë e materialeve, metodave të mësimdhënies dhe mbështetjes profesionale krijojnë pabarazi në përvojën e të nxënësve dhe kufizojnë mundësinë që çdo nxënës të zhvillojë potencialin e tij në përputhje me nevojat individuale.

3.3 Zbatim (Shërbimet mbështetëse - asistentë, staf profesional)

Ky kapitull trajton zbatimin në praktikë të mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA), duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve mbështetëse nga asistentët e fëmijëve/nxënësve, mësuesit mbështetës dhe stafi profesional në shkolla. Kemi vlerësuar nëse këto shërbime janë planifikuar dhe organizuar në përputhje me nevojat e identifikuar të nxënësve, nëse janë të mjaftueshme në numër dhe profil profesional, si dhe nëse ofrohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të koordinuar për të mbështetur përfshirjen dhe pjesëmarrjen efektive të nxënësve me NVA në procesin mësimor.

3.3.1 DKA-të nuk kanë siguruar kapacitetet e nevojshme për arsimin gjithëpërfshirës

Drejtoritë Komunale të Arsimit duhet të sigurojnë kapacitetet e nevojshme organizative, profesionale dhe mbështetëse për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës, duke krijuar struktura funksionale koordinuese dhe duke planifikuar burimet njerëzore në përputhje me nevojat e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Këto kapacitete duhet të mundësojnë koordinimin efektiv ndërmjet shkollave, stafit profesional, qendrave burimore dhe institucioneve të tjera relevante²³.

Komunat duhet të sigurojnë qasje në asistentë për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore bazuar në nevojat e identifikuar dhe rekomandimet profesionale, në mënyrë që të mbështetët pjesëmarrja dhe përfshirja e tyre në procesin mësimor²⁴. Kapacitetet dhe shërbimet mbështetëse duhet të

²³ Strategjia e Arsimit 2022–2026; Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2025–2030

²⁴ UA Nr. 19/2023 për Asistentët e Fëmijëve/Nxënësve **30** Nevoja të Veçanta Arsimore

planifikohen në përputhje me nevojat reale të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të kontribuojnë në pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në arsim²⁵.

Gjendja në nivel të shkollave dhe komunave sa i përket ofrimit të shërbimeve mbështetëse për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA) nuk paraqitet e kënaqshme. Numri i nxënësve me NVA është dukshëm më i lartë krahasuar me numrin e asistentëve, mësuesve mbështetës dhe stafit profesional të angazhuar në shkolla.

Për më tepër, në disa shkolla është evidentuar mungesa e psikologëve dhe pedagogëve, të cilët kanë rol kyç jo vetëm në mbështetjen e nxënësve me NVA, por edhe në ofrimin e mbështetjes psiko-sociale dhe pedagogjike për nxënësit në përgjithësi.

Drejtoritë Komunale të Arsimit në komunat e audituara nuk kanë siguruar staf të dedikuar dhe funksional për arsimin gjithëpërfshirës, duke kufizuar organizimin dhe menaxhimin efektiv të shërbimeve mbështetëse për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA).

Në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Prishtinë, është evidentuar se funksioni i zyrtarit për arsimin gjithëpërfshirës nuk është i plotësuar në mënyrë efektive. Aktualisht, vetëm një zyrtar ushtron këtë funksion, i cili, përveç përgjegjësi që lidhen me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore (FNVA), është i angazhuar edhe në detyra të tjera sipas organizimit të brendshëm dhe planit të veprimit të departamentit, ndonëse në përshkrimin formal të detyrave ka të specifikuar vetëm fushën e gjithëpërfshirjes²⁶.

Në strukturën e kësaj DKA-je ekziston edhe një zyrtar tjetër për këtë fushë. Megjithatë, nga verifikimi i dokumentacionit është konstatuar se kjo zyrtare, ndonëse ka kontratë si zyrtare e lartë për gjithëpërfshirje, është e angazhuar në kabinetin e Kryetarit të Kuvendit Komunal të Prishtinës. Për më tepër, kjo pozitë nuk është zëvendësuar, duke rezultuar në mungesë të kapaciteteve të dedikuara për menaxhimin e arsimit gjithëpërfshirës në nivel komunal.

Sipas sqarimeve të ofruara nga DKA Prishtinë, institucioni ka në dispozicion vetëm një organogram të hartuar më herët, ndërsa organogrami i ri me planifikim në sektor është në proces hartimi nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe ende nuk është finalizuar. Si rrjedhojë, nuk është siguruar një pasqyrë e përditësuar dhe e qartë mbi strukturën aktuale organizative dhe pozitat e dedikuara për arsimin gjithëpërfshirës.

Kjo situatë, e shoqëruar edhe me mungesën e dokumentacionit të plotë për pozitat ekzistuese (përfshirë kontratën e zyrtarit të dytë të përmendur për gjithëpërfshirje), tregon për mungesë të qartësisë dhe transparencës në menaxhimin e kapaciteteve njerëzore në këtë fushë.

²⁵ Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2025–2030; UNICEF Child Protection Index

²⁶ Përshkrimi i detyrave të punës për zyrtar në gjithëpërfshirje bazuar në konkurs, akt emerim albulena ahmeti
(1)

Në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Pejë, është evidentuar se funksioni i zyrtarit për arsimin gjithëpërfshirës nuk është i siguruar në mënyrë të qëndrueshme. Sipas informacioneve të siguruara, zyrtari përgjegjës për këtë fushë është transferuar në një pozitë tjetër që nga marsi i vitit 2025, ndërsa kjo pozitë nuk është zëvendësuar për një periudhë të gjatë.

Në mungesë të një zyrtari të dedikuar, përgjegjësitë për arsimin gjithëpërfshirës janë shpërndarë përkohësisht tek zyrtarë të tjerë brenda DKA-së, pa një përcaktim të qartë të roleve dhe përgjegjësi, duke krijuar paqartësi në menaxhimin dhe koordinimin e mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Sipas sqarimeve të ofruara nga DKA Pejë, me hyrjen në fuqi të katalogut të ri të vendeve të punës, nuk ekziston më emërtimi i veçantë për “Zyrtar të arsimit gjithëpërfshirës”, por vetëm pozita e përgjithshme “Zyrtar i arsimit”. Një zyrtarë e punësuar gjatë vitit të kaluar aktualisht ndodhet në pushim të lehonisë, ndërsa është planifikuar që pas kthimit të saj të marrë përgjegjësitë për këtë fushë. Deri atëherë, këto detyra janë shpërndarë përkohësisht tek zyrtarë të tjerë.

Në Komunën e Mitrovicës, gjendja paraqitet më kritike, pasi që kjo drejtori nuk ka pasur asnjëherë zyrtar të dedikuar për arsimin gjithëpërfshirës, duke reflektuar mungesë të plotë të kapaciteteve institucionale në këtë fushë.

Në Komunën e Mitrovicës, mungesa e zyrtarit për arsimin gjithëpërfshirës lidhet me faktin se kjo pozitë nuk është konsideruar si prioritet nga drejtuesit e DKA-së dhe qeverisja lokale. Si rrjedhojë, ajo nuk është përfshirë në Rregulloren për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e administratës komunale.

Shkak kryesor i kësaj gjendjeje është mungesa e planifikimit të qëndrueshëm organizativ të arsimit gjithëpërfshirës në nivel komunal. Në disa raste, pozitat ekzistuese nuk janë funksionalizuar ose janë përdorur për detyra të tjera, ndërsa në raste të tjera funksioni nuk është përfshirë fare në strukturën organizative të komunës.

Si pasojë, DKA-të nuk kanë mekanizëm të qartë dhe të qëndrueshëm për koordinimin, planifikimin dhe monitorimin e mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Kjo ka ndikuar që planifikimi i shërbimeve mbështetëse të mos bazohet gjithmonë në analiza të strukturuar të nevojave, ndërsa koordinimi ndërmjet shkollave, stafit profesional, prindërve dhe institucioneve mbështetëse mbetet i pakoordinuar dhe jo i qëndrueshëm. Në mungesë të përgjegjësi të qarta në nivel komunal, rritet rreziku që nevojat e nxënësve me NVA të mos identifikohen, planifikohen dhe adresohen me kohë dhe në mënyrë të barabartë ndërmjet shkollave.

3.3.2 DKA-të nuk planifikojnë dhe sigurojnë staf mbështetës sipas nevojave reale të nxënësve me Nevoja të Veçanta Arsimore

Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore duhet të kenë qasje në mbështetje të përshtatshme profesionale dhe pedagogjike, në përputhje me nevojat e identifikuar dhe rekomandimet e vlerësimit pedagogjik²⁷. Drejtoritë Komunale të Arsimit duhet të planifikojnë dhe të sigurojnë numër të mjaftueshëm të stafit mbështetës, përfshirë asistentët e fëmijëve/nxënësve me NVA, bazuar në nevojat reale të nxënësve dhe shkollave²⁸. Shërbimet mbështetëse duhet të organizohen dhe të ofrohen në mënyrë të qëndrueshme, të koordinuar dhe të qasshme për të gjithë nxënësit që kanë nevojë për to²⁹.

Në Drejtoritë Komunale të Arsimit, planifikimi dhe shpërndarja e stafit mbështetës për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore realizohet në kuadër të planifikimit të përgjithshëm të personelit arsimor. Gjatë auditimit u analizua nëse ky planifikim bazohet në nevojat reale të nxënësve me NVA, duke marrë parasysh numrin e tyre, profilin e nevojave dhe nivelin e mbështetjes së kërkuar.

Auditimi konstatoi se DKA-të nuk planifikojnë dhe nuk sigurojnë staf mbështetës në bazë të nevojave reale të nxënësve me NVA. Analiza e të dhënave dhe vëzhgimet në terren tregojnë se planifikimi dhe shpërndarja e asistentëve, mësuesve mbështetës dhe stafit profesional nuk mbështetet në një vlerësim të strukturuar të nevojave në nivel komunal apo shkollor. Analiza e praktikave në Drejtoritë Komunale të Arsimit tregon se planifikimi dhe shpërndarja e stafit mbështetës për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nuk bazohet në një vlerësim të strukturuar të nevojave reale në nivel komunal apo shkollor.

Në të tri komunat e audituara është konstatuar se numri i asistentëve, mësuesve mbështetës dhe stafit profesional trajtohet si pjesë e përgjithshme e numrit të mësimdhënësve në komunë, pa një ndarje të qartë dhe planifikim të dedikuar për nxënësit me NVA. Si rrjedhojë, nuk ekziston një standard i qartë për përcaktimin e nevojave për staf mbështetës në bazë të numrit, profilit dhe nivelit të mbështetjes që kërkojnë nxënësit.

Shpërndarja e stafit në praktikë realizohet kryesisht në bazë të nevojave të paraqitura nga shkollat, ankesat e prindërve apo raste të veçanta, dhe jo në analiza të mirëfillta të të dhënave apo kritere të standardizuara. Në mungesë të një qasjeje të tillë, vendimarrja për alokimin e stafit mbështetës mbetet jo e strukturuar dhe e paqëndrueshme ndërmjet shkollave.

Në kuadër të Strategjisë së Arsimit 2022–2026, MASHTI ka paraparë rritjen graduale të numrit të asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, me synim prej 100 asistentësh shtesë në vit. Kjo mbështetje është reflektuar edhe përmes grantit specifik për arsimin

²⁷ Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar; Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2025–2030

²⁸ UA Nr. 19/2023 për Asistentët e Fëmijëve/Nxënësve me Nevoja të Veçanta Arsimore

²⁹ Strategjia e Arsimit 2022–2026; UNICEF Child Protection Index

parauniversitar, ku janë planifikuar mjete dhe pozita për asistentë të shpërndara sipas komunave. Për vitin 2025, dokumentacioni i grantit specifik parasheh gjithsej 500 asistentë, prej të cilëve 67 për Prishtinën, 32 për Pejën dhe 28 për Mitrovicën³⁰. Kjo dëshmon mbështetjen dhe planifikimin financiar të nivelit qendror për rritjen e kapaciteteve mbështetëse.

Megjithatë, evidencat e ofruara nuk dëshmojnë se shpërndarja e stafit brenda tri komunave të audituara është mbështetur në analiza të dokumentuara që ndërlidhin numrin dhe profilin e stafit mbështetës me numrin e nxënësve me NVA, llojin dhe intensitetin e nevojave të tyre, rekomandimet e EVK-ve dhe nevojat konkrete të shkollave. Për rrjedhojë, ndonëse ekziston mbështetje dhe planifikim financiar nga niveli qendror, mbetet mangësi planifikimi i bazuar në nevoja për shpërndarjen e kapaciteteve mbështetëse në nivel komunal dhe shkollor..

Tabela 7 Statistika totale te stafit mbështetës neper komuna

Shkolla	Nxënës	Fëmijë me Nevoja të veçanta	Shkolla me zero NVA	Asistent	Mësues Mbështetës	Psikolog	Pedagog
Drejtoria Komunale e Arsimit Prishtinë							
40	28,350	551	5	61	28	38	19
Drejtoria Komunale e Arsimit Pejë							
26	10,567	136	9	25	7	22	6
Drejtoria Komunale e Arsimit Mitrovicë							
26	8,964	173	8	5	5	2	9

³⁰ MASHTI – Granti specifik për arsimin parauniversitar, dokumentet e planifikimit/vlerësimit të grantit për periudhat 2022–2024, 2023–2025, 2024–2026 dhe vlerësimet 2025–2026.

Tabela 8 Shpërndarja e stafit mbështetës në shkollat në Prishtinë, Mitrovicë dhe Pejë

Drejtoria Komunale e Arsimit Prishtinë								
Shkolla	Total Nxënës	FNVA	Psikolog	Mësues Mbështetës	Asistent	Total Staf Mbështetës	%	Asistent Privat
Ismail Gernali	2,889	53	1	2	6	9		20
Hasan Prishtina	2,259	34	1	1	4	6		2
Meto Bajraktari	1,300	33	1	1	2	4		2
Enin Duraku	748	4	1	1	1	3		0
Diturija	179	0	1	0	0	1		0
Drejtoria Komunale e Arsimit Pejë								
Shkolla	Total Nxënës	FNVA	Psikolog	Mësues Mbështetës	Asistent	Total Staf Mbështetës	%	Asistent Privat
Ramiz Sadiku	650	14	1	3	1	5		0
Asdreni	1,114	15	1	0	3	4		0
Drejtoria Komunale e Arsimit Mitrovicë								
Shkolla	Total Nxënës	FNVA	Psikolog	Mësues Mbështetës	Asistent	Total Staf Mbështetës	%	Asistent Privat
Anton Zako Çajupi	785	4	1	1	0	2		0
Abdullah Shabani	1,082	1	0	1	0	1		0
Migjeni	1,062	23	1	1	1	3		0

Të dhënat e paraqitura në tabelat e mësipërme tregojnë një disbalancë të konsiderueshme ndërmjet numrit të nxënësve me NVA dhe kapaciteteve të stafit mbështetës në dispozicion në komunat dhe shkollat e përzgjedhura. Në shumë raste, mbështetja ofrohet vetëm për një pjesë të nxënësve, ndërsa për të tjerët mungon plotësisht ose është e kufizuar në kohë.

Në nivel komunal, në Komunën e Prishtinës janë gjithsej 61 asistentë, në Komunën e Pejës 25 asistentë, ndërsa në Komunën e Mitrovicës vetëm 5 asistentë të angazhuar për mbështetjen e nxënësve me NVA. Këto kapacitete rezultojnë të pamjaftueshme kur krahasohen me numrin e përgjithshëm të nxënësve me NVA në secilën komunë.

Tabela 9 Raporti nxënës-asistent për nx. me NVA sipas Komunave

Komuna	Nr. i nxënësve me NVA	Nr. i asistentëve të angazhuar	Raporti Nx/As (Nxënës për Asistent)	Standardi UA: 1:1 ose 1:2	Diferenca
 Prishtinë	551	61	1:9	1:2	+7
 Mitrovicë	173	25	1:35	1:2	+32
 Pejë	136	5	1:5	1:2	+3

Siç evidentohet nga tabela e analizës së raportit nxënës–asistent, ekziston një disproportcion i konsiderueshëm ndërmjet nevojave dhe kapaciteteve në dispozicion. Në Komunën e Prishtinës raporti mesatar është rreth 1 asistent për 9 nxënës me NVA, në Pejë rreth 1 për 5 nxënës, ndërsa në Mitrovicë situata është dukshëm më kritike, me rreth 1 asistent për 35 nxënës. Ky raport nuk nënkupton mbështetje të drejtpërdrejtë për këtë numër nxënësish nga një asistent, por reflekton mungesë të theksuar të kapaciteteve për të përmbushur standardin e mbështetjes individuale (1:1 ose 1:2).

Ky disproportcion reflektohet drejtpërdrejt edhe në nivel të shkollave të përzgjedhura. Në Komunën e Prishtinës, shkolla “Ismail Qemali” ka 53 nxënës me NVA dhe vetëm 6 asistentë, “Hasan Prishtina” ka 34 nxënës me NVA dhe 4 asistentë, ndërsa “Meto Bajraktari” ka 33 nxënës me NVA dhe vetëm 2 asistentë. Në shkollën “Emin Duraku” janë 4 nxënës me NVA dhe 1 asistent, ndërsa në shkollën “Dituria” nuk ka nxënës të identifikuar me NVA.

Situata paraqitet edhe më kritike në Komunën e Mitrovicës, ku nga tri shkollat e përzgjedhura në mostër, vetëm njëra prej tyre, shkolla “Migjeni”, ka të angazhuar një asistent, ndonëse ka 23 nxënës me NVA. Ndërsa shkollat “Anton Zako Çajupi” dhe “Abdullah Shabani” nuk kanë asnjë asistent të angazhuar, pavarësisht se në total kanë 5 nxënës me NVA.

Tabela 10 Raporti nxënës-asistent për nx. me NVA sipas shkollave

Komuna	Shkolla	Nxënës me NVA	Asistentë	Raporti (Nx/As)
Prishtinë	Ismail Qemali	53	6	1 : 8.8
Prishtinë	Hasan Prishtina	34	4	1 : 8.5
Prishtinë	Meto Bajraktari	33	2	1 : 16.5
Prishtinë	Emin Duraku	4	1	1 : 4
Prishtinë	Dituria	0	0	-
Mitrovicë	Migjeni	23	1	1 : 23
Mitrovicë	Anton Zako Çajupi	4	0	! Pa asistent
Mitrovicë	Abdullah Shabani	1	0	! Pa asistent
Pejë	Ramiz Sadiku	14	1	1 : 14
Pejë	Asdreni	15	3	1 : 5

Në këto kushte, edhe në rastet kur mbështetja me asistent ofrohet, ajo nuk është e vazhdueshme dhe nuk i përgjigjet plotësisht nevojave të nxënësve.

Megjithëse në disa shkolla është i angazhuar një numër i caktuar asistentësh (p.sh. 6 asistentë në shkollën “Ismail Qemali”), kjo nuk nënkupton që 12 nxënës përfitojnë mbështetje të plotë gjatë gjithë kohës mësimore.

Për shkak të mungesës së asistentëve, në praktikë ata angazhohen për periudha të kufizuara kohore (zakonisht 2–3 orë gjatë ditës) me një ose dy nxënës, dhe më pas lëvizin për të mbështetur nxënës të tjerë me NVA brenda së njëjtës shkollë. Si rezultat, mbështetja që ofrohet është e kufizuar në kohë dhe nuk është e vazhdueshme për asnjërin nga nxënësit.

Në pjesën tjetër të kohës mësimore, kur nxënësit mbesin pa mbështetje nga asistenti, barra për ofrimin e mbështetjes bie mbi mësimdhënësin e klasës dhe, në disa raste, edhe mbi vetë nxënësit e tjerë. Kjo situatë ndikon negativisht jo vetëm në cilësinë e mbështetjes për nxënësit me NVA, por edhe në kohën efektive të të nxënësve në klasë.

Në praktikë, mësimdhënësi detyrohet të devijojë nga plani mësimor për t’u përqendruar në mbështetjen individuale të këtyre nxënësve, duke reduktuar kohën e dedikuar për zhvillimin e mësimin për të gjithë klasën. Si rezultat, procesi mësimor bëhet më pak i strukturuar dhe më pak efikas, duke ndikuar si në progresin e nxënësve me NVA, ashtu edhe në përvojën e të nxënësve për nxënësit e tjerë.

Mungesa e mbështetjes së vazhdueshme nga asistentët ndikon gjithashtu në menaxhimin e klasës dhe në sigurinë gjatë procesit mësimor. Gjatë vizitave në terren janë identifikuar raste

ku, në mungesë të mbështetjes adekuate, mësimdhënësit janë përballur me situata të vështira në menaxhimin e sjelljeve sfiduese të nxënësve me NVA.

Në disa raste konkrete, si në shkollën “Ismail Qemali”, janë raportuar situata ku nxënësit kanë shfaqur sjellje të pakontrolluara që kanë kaluar deri në incidente ndaj mësimdhënësve.

Kjo situatë lidhet me mungesën e një planifikimi të strukturuar dhe të bazuar në vlerësimin e nevojave reale për staf mbështetës në nivel komunal dhe qendror. Auditimi konstatoi se planifikimi dhe shpërndarja e asistentëve, mësuesve mbështetës dhe profileve të tjera profesionale nuk mbështetet në analiza të rregullta të nevojave të nxënësve me NVA, ndërsa koordinimi ndërmjet MASHTI-t, DKA-ve dhe shkollave për identifikimin dhe adresimin e këtyre nevojave mbetet i kufizuar. Për më tepër, planifikimi buxhetor realizohet në kuadër të kategorisë së përgjithshme të pagave, pa një planifikim të dedikuar për stafin mbështetës, gjë që kufizon mundësinë për rritjen e kapaciteteve në përputhje me nevojat reale.

Në mungesën e këtij planifikimi sistematik kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë, si disponueshmëria e kufizuar e kuadrove të kualifikuara për pozitën e asistentit, për shkak të profesionalizimit relativisht të vonshëm të këtij profili, si dhe mungesa e trajnimeve të vazhdueshme profesionale për stafin mbështetës. Edhe pse procedurat dhe kriteret për rekrutimin e mësuesve mbështetës dhe asistentëve janë të përcaktuara në kuadrin rregullativ në fuqi, ato nuk janë reflektuar në mënyrë efektive në planifikimin dhe shpërndarjen e stafit në praktikë.

Si rezultat, mbështetja për nxënësit me NVA nuk ofrohet në mënyrë të barabartë dhe të vazhdueshme në të gjitha shkollat. Numri i pamjaftueshëm i stafit mbështetës bën që asistentët të mbulojnë njëkohësisht disa nxënës, duke kufizuar kohën dhe cilësinë e mbështetjes individuale. Kjo rrit ngarkesën e mësimdhënësve, vështirëson menaxhimin e klasës dhe kufizon mundësinë që nxënësit me NVA të përfitojnë mbështetje të përshtatshme gjatë gjithë procesit mësimor.

3.3.3 Mungesa e psikologëve dhe pedagogëve kufizon mbështetjen profesionale për nxënësit me Nevoja të Veçanta Arsimore

Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe institucionet arsimore duhet të sigurojnë kapacitete të mjaftueshme profesionale, përfshirë psikologë dhe pedagogë, për të mbështetur identifikimin e nevojave, planifikimin e mbështetjes, monitorimin e progresit dhe mirëqenien e nxënësve³¹. Shërbimet profesionale duhet të jenë të qasshme dhe të organizuara në mënyrë që të ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për nxënësit, prindërit dhe stafin arsimor³².

Roli i psikologut është gjithëpërfshirës dhe përfshin identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të nxënësve, ofrimin e mbështetjes psiko-sociale, zhvillimin e ndërhyrjeve individuale dhe në grup, këshillimin e mësimeve, si dhe bashkëpunimin me prindërit dhe institucionet relevante. Po ashtu, psikologu ka rol kyç në hartimin dhe zbatimin e Planeve Individuale të Arsimit (PIA), në monitorimin e progresit të nxënësve dhe në zhvillimin e programeve parandaluese³³.

Si rezultat, mbështetja psiko-sociale dhe pedagogjike për nxënësit me NVA nuk ofrohet në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme. Në praktikë, kjo përkthehet në mungesë të vlerësimit të rregullt të nevojave, mungesë të ndjekjes së progresit dhe mbështetje të kufizuar për mësime në menaxhimin e klasës dhe zbatimin e qasjeve gjithëpërfshirëse.

Analiza e të dhënave dhe vëzhgimet në terren tregojnë se numri i stafit profesional mbështetës, në veçanti psikologëve dhe pedagogëve, është i pamjaftueshëm në raport me numrin e nxënësve dhe nevojat e tyre në shkollat e përzgjedhura.

Në nivel komunal, situata paraqitet veçanërisht problematike në Komunën e Mitrovicës, ku për 26 shkolla fillore janë të angazhuar vetëm 2 psikologë. Edhe në komunat e tjera, ndonëse numri i psikologëve është më i lartë, shpërndarja e tyre nuk është proporcionale me numrin e nxënësve dhe kompleksitetin e nevojave nëpër shkolla.

Në nivel të shkollave të përzgjedhura, janë identifikuar raste ku mungon plotësisht stafi profesional. Për shembull, në shkollën “Hasan Prishtina” në Prishtinë nuk ka pasur pedagog për një periudhë të gjatë kohore, ndërsa në disa shkolla në Mitrovicë mungojnë njëkohësisht edhe psikologu edhe pedagogu. Në shkollën “Abdullah Shabani”, për një numër prej mbi 1,000 nxënësish, nuk është i angazhuar as psikolog dhe as pedagog, ndërsa në shkollën “Anton Zako Çajupi” mungon pedagogu.

³¹ Strategjia e Arsimit 2022–2026; Udhëzuesi për Arsimin Gjithëpërfshirës, MASHTI

³² UNICEF Child Protection Index; Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2025–2030

³³ Udhëzimin Administrativ për funksionimin e shërbimit pedagogjik–psikologjik (2014)

Në këto kushte, edhe aty ku ekziston një psikolog, mbulimi i një numri të madh nxënësish e bën të pamundur ofrimin e mbështetjes së rregullt dhe të individualizuar. Duke marrë parasysh standardin orientues prej rreth 1 psikolog për 1,000 nxënës, në disa shkolla ky raport tejkalohet ndjeshëm, duke kufizuar ndjeshëm rolin e psikologut në mbështetjen e nxënësve me NVA.

Gjatë auditimit janë evidentuar edhe raste që tregojnë mungesë të qartësisë profesionale lidhur me identifikimin dhe kategorizimin e nxënësve me NVA. Në një nga shkollat e vizituara, gjatë intervistës me stafin profesional, specifikisht me psikologun, është vërejtur paqartësi lidhur me diagnozat dhe rastet që konsiderohen pjesë e kategorisë së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Po ashtu, në listat e evidentuara si raste të nxënësve me NVA janë përfshirë edhe raste të nxënësve me ankth dhe depresion, pa pasur qartësi të mjaftueshme mbi kriteret dhe bazën e klasifikimit të tyre në këtë kategori.

Kjo situatë tregon nevojën për udhëzime më të qarta profesionale dhe ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve të stafit profesional lidhur me identifikimin, kategorizimin dhe trajtimin e nxënësve me NVA.

Edhe rezultatet e pyetësorit me prindërit mbështesin këtë konstatim. Prindërit kanë theksuar nevojën për mbështetje më të madhe nga psikologët dhe pedagogët në shkolla, veçanërisht në aspektin e zhvillimit social dhe emocional të fëmijëve, bashkëpunimit me familjen dhe koordinimit me mësimdhënësit. Sipas tyre, mbështetja ekzistuese shpesh fokusohet në aspektin akademik, ndërsa nevojat për këshillim, socializim dhe përcjellje të vazhdueshme mbeten të pamjaftueshme.

Megjithatë, gjatë vizitave në terren është vërejtur se në disa shkolla ku është i angazhuar psikologu, si në shkollat “Hasan Prishtina”, “Ismail Qemali” dhe “Meto Bajraktari”, si dhe në shkollat “Migjeni”, “Anton Zako Çajupi” dhe “Abdullah Shabani” në Komunën e Mitrovicës, ekzistojnë plane vjetore të punës të strukturuar, të cilat përfshijnë aktivitete si identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të nxënësve, këshillimi individual dhe në grup, bashkëpunimi me mësimdhënësit dhe prindërit, si dhe zhvillimi i programeve parandaluese dhe mbështetëse.

Këto plane zakonisht përmbajnë objektiva të qarta, aktivitete të planifikuara sipas periudhave kohore dhe indikatorë për ndjekjen e progresit, duke reflektuar një qasje të strukturuar dhe profesionale në organizimin e punës së psikologut në shkollë.

Në varësi të nevojave konkrete të nxënësve dhe rasteve të identifikuara, këto plane pësojnë përshtatje gjatë vitit shkollor, duke reflektuar fleksibilitet dhe përshtatje ndaj nevojave të nxënësve. Ekzistenca e planeve vjetore krijon një bazë të strukturuar për planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve të psikologut në shkollë.

Kjo situatë lidhet me mungesën e planifikimit të bazuar në nevoja për stafin profesional, si dhe me kufizimet buxhetore dhe organizative në nivel komunal. Po ashtu, mungesa e prioritizimit të këtyre pozicioneve dhe mungesa e analizave të rregullta mbi nevojat e shkollave kanë ndikuar në mosplotësimin e këtyre kapaciteteve.

Mungesa e psikologëve dhe pedagogëve kufizon ndjeshëm ofrimin e mbështetjes profesionale për nxënësit me NVA, duke ndikuar në cilësinë e përfshirjes së tyre në procesin mësimor dhe në funksionimin efektiv të mjedisit të të nxënësve në klasë.

3.3.4 Mungesa e udhëzimeve të qarta për bashkëpunimin ndërmjet shkollave dhe asistentëve privatë

Mbështetja për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në institucionet publike arsimore duhet të ofrohet nga personel i autorizuar, i përzgjedhur sipas procedurave të përcaktuara dhe i angazhuar në përputhje me legjislacionin në fuqi³⁴. Institucionet arsimore janë përgjegjëse për organizimin, mbikëqyrjen dhe sigurinë e procesit edukativo-arsimor, ndërsa personat që ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për nxënësit duhet të kenë role, përgjegjësi dhe mbikëqyrje të qartë institucionale³⁵.

Në shkollat e përzgjedhura është evidentuar prania e asistentëve privatë të angazhuar nga prindërit për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Ky angazhim realizohet në mënyrë joformale, pa një procedurë të standardizuar dhe pa udhëzime të qarta institucionale për rolin, përgjegjësitë dhe bashkëpunimin e tyre me stafin shkollor.

Në Drejtoritë Komunale të Arsimit nuk ekziston një mekanizëm formal për miratimin, licencimin apo monitorimin e këtyre asistentëve, dhe nuk janë lëshuar leje zyrtare për angazhimin e tyre. Si rrjedhojë, shkollat në praktikë vetëm njoftohen për praninë e tyre, pa pasur rol të qartë në përzgjedhjen, mbikëqyrjen apo vlerësimin e tyre.

Në nivel komunal, fenomeni i angazhimit të asistentëve privatë është veçanërisht i përhapur në Komunën e Prishtinës dhe nuk kufizohet vetëm në shkollat e përzgjedhura në mostër, por paraqet një praktikë më të gjerë në disa institucione arsimore.

Në shkollën “Ismail Qemali”, numri i asistentëve privatë të angazhuar nga prindërit tejkalon 20 asistent, duke reflektuar nevojën për mbështetje shtesë për një numër të konsiderueshëm nxënësish me NVA.

Në shkollën “Hasan Prishtina” është identifikuar një praktikë më e strukturuar, ku është hartuar një marrëveshje e brendshme ndërmjet prindit, mësimdhënësit, mësuesit mbështetës dhe asistentit privat. Kjo marrëveshje përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e asistentit, duke

³⁴ Igi Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 7, 39; UA Nr. 19/2023 për Asistentët e Fëmijëve/Nxënësve me Nevoja të Veçanta Arsimore

³⁵ Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, nenet 7, 39 dhe 40; UA Nr. 19/2023

përfshirë ofrimin e mbështetjes individuale për nxënësin, monitorimin e progresit, bashkëpunimin me stafin shkollor dhe respektimin e konfidencialitetit të të dhënave të nxënësit.

Megjithatë, kjo marrëveshje nuk përbën një mekanizëm formal të miratuar në nivel institucional dhe mbetet një zgjidhje e zhvilluar në nivel shkolle, duke reflektuar përpjekjet për të menaxhuar një praktikë që nuk është e rregulluar nga sistemi. Për ilustrim, në figurën në vijim paraqitet forma e marrëveshjes së brendshme të përdorur nga shkolla për përcaktimin e rolit dhe përgjegjësi të asistentit privat.

Shf&shmu "Hasan Prishtina" Prishtinë

Marrëveshje për Mbështetje të Fëmijës me Nevoja të Veçanta

Marrëveshje e bërë më datën _____, në mes të mësimdhënëses mbështetëse _____, Prindit _____, mësueses së klasës _____ dhe asistentit/es së nxënësit/es _____, kl. _____.

Mësimdhënësj mbështetëse, prindi, mësuesja e klasës dhe asistentja e nxënësit janë të përfshira në këtë marrëveshje, për të siguruar mbështetje efektive dhe të përshtatshme për nxënësin në mjedisin shkollor. Kjo marrëveshje synon të përmirësoj përvojën e arsimit dhe integroj fëmijët me nevoja të veçanta në komunitetin shkollor.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Asistentja do të ofroj ndihmë dhe mbështetje individuale ose grupore në mënyrë të përshtatshme me nevojat e tyre.
2. Asistentja do të monitoroj dhe do të raportoj progresin e fëmijës drejt prindit dhe mësimdhënëses dhe mësimdhënësit mbështetëse.
3. Së bashku me mësimdhënësen mbështetëse dhe mësuesen e klasës të bashkëpunojnë për të zhvilluar plane, strategji efektive, të përgatitin materiale didaktike për të arritur rezultatet e përcaktuara në-PIA.
4. Asistentja do të respektoj dhe ta ruaj privatësinë e të dhënave të nxënësit dhe nuk do të ndajë informacione pa lejen të prindit të tij/saj.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të vazhdoj të jetë në fuqi me një periudhë të caktuar.

Prindi: _____

Mësuesi i klasës: _____

Mësimdhënësj mbështetëse: _____

Asistentja: _____

Figura 7 Forma e marrëveshjes së brendshme të përdorur nga shkolla "Hasan Prishtina" ne Prishtine për përcaktimin e rolit dhe përgjegjësi të asistentit privat.

Ndërkohë, shkolla të tjera, si "Meto Bajraktari", kanë deklaruar se janë detyruar të lejojnë praninë e asistentëve privatë për të kompensuar mungesën e mbështetjes institucionale, duke reflektuar një nevojë reale dhe të paplotësuar për mbështetje për nxënësit me NVA.

Në komunat e Pejës dhe Mitrovicës, në përgjithësi nuk lejohet angazhimi i asistentëve privatë, pasi që kjo konsiderohet në kundërshtim me rregullat për funksionimin e institucioneve publike. Megjithatë, janë identifikuar raste të veçanta ku prindërit kanë siguruar përcjellës për

periudha të shkurtra (p.sh. gjatë adaptimit të nxënësve), çka tregon se nevoja për mbështetje ekziston edhe në këto komuna, por nuk adresohet në mënyrë të strukturuar.

Në tërësi, kjo situatë ka krijuar një praktikë të pa standardizuar ndërmjet komunave, ku në disa raste angazhimi i stafit privat tolerohet si zgjidhje alternative, ndërsa në raste të tjera refuzohet plotësisht, duke rezultuar në qasje të pabarabarta për nxënësit me NVA në nivel vendi.

Edhe rezultatet e pyetësorit me prindërit mbështesin këtë konstatim. Prindërit kanë deklaruar se angazhimi i asistentëve privatë lidhet kryesisht me mungesën e asistentëve të siguruar nga DKA-të ose me orarin e pamjaftueshëm të mbështetjes së ofruar nga ta. Po ashtu, nga 15 prindër që iu përgjigjën pyetësorit, 10 kanë deklaruar se asistenti privat ishte pranuar nga shkolla, ndërsa 5 kanë deklaruar se nuk kishte një aprovim formal. Këto rezultate tregojnë se praktikat e bashkëpunimit ndërmjet shkollave dhe asistentëve privatë nuk janë të njëtrajtshme dhe zhvillohen pa udhëzime të qarta dhe të standardizuara. Megjithatë kuadri ekzistues përcakton që mbështetja për nxënësit me NVA të ofrohet nga personel i autorizuar, nga MASHTI dhe DKA nuk janë përcaktuar udhëzime, procedura dhe përgjegjësi të qarta për trajtimin e rasteve kur prindërit angazhojnë asistentë privatë në shkolla publike. Si rezultat, në rastet kur komunat nuk arrijnë të sigurojnë asistentë të mjaftueshëm, prindërit angazhojnë asistentë privatë, ndërsa shkollat përballen me paqartësi lidhur me mënyrën e bashkëpunimit, koordinimit dhe mbikëqyrjes së tyre në procesin mësimor.

Si pasojë, kjo krijon pabarazi në qasje ndaj shërbimeve, pasi vetëm familjet që kanë mundësi financiare mund të sigurojnë mbështetje shtesë, ndërsa nxënësit e tjerë mbesin pa mbështetje adekuate. Në të njëjtën kohë, prania e stafit joformal brenda shkollave, jashtë procedurave të rekrutimit dhe mbikëqyrjes institucionale, rrit rrezikun për cenimin e konfidencialitetit të të dhënave, mungesën e standardeve profesionale dhe tejkalimin e roleve dhe përgjegjësi në procesin mësimor.

3.4 Mangësi në monitorimin dhe koordinimin nga MASHTI

Sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar³⁶ dhe udhëzimeve administrative për arsimin gjithëpërfshirës³⁷, MASHTI ka rol kyç në zhvillimin, koordinimin dhe monitorimin e politikave për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. MASHTI duhet të sigurojë funksionimin efektiv të mekanizmave të vlerësimit pedagogjik, monitorimin e zbatimit të Planeve Individuale Arsimore dhe mbledhjen e analizimin e të dhënave përmes sistemit Sistemit për Menaxhimin e Informatave në Arsim³⁸. Po ashtu, MASHTI duhet të monitorojë funksionalitetin e Ekipeve Vlerësuese Komunale dhe të planifikojë kapacitetet profesionale dhe mbështetëse bazuar në nevojat reale të shkollave dhe nxënësve³⁹.

Ndonëse MASHTI ka zhvilluar një kuadër relativisht të avancuar ligjor dhe administrativ për arsimin gjithëpërfshirës, monitorimi dhe koordinimi i zbatimit të këtij kuadri në praktikë mbetet i kufizuar. Mungesa e mekanizmave efektivë të monitorimit, analizës së të dhënave dhe raportimit sistematik ka ndikuar që mangësitë e evidentuara në nivel të shkollave dhe komunave të mos identifikohen dhe adresohen me kohë.

Një nga mangësitë kryesore të evidentuara gjatë auditimit lidhet me cilësinë, verifikimin dhe koordinimin institucional të të dhënave të raportuara në Sistemin për Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA). Gjatë auditimit janë evidentuar raste të dallimeve të konsiderueshme ndërmjet të dhënave të raportuara në SMIA dhe gjendjes faktike të evidentuar në terren. Në disa shkolla janë evidentuar rritje të papritura të numrit të nxënësve me NVA ndër vite, ndërsa në raste të tjera shkolla kanë raportuar zero raste, megjithëse gjatë vizitave në terren janë identifikuar nxënës me nevoja evidente për mbështetje pedagogjike.

Për të kuptuar mekanizmat e verifikimit të këtyre të dhënave, auditimi ka kërkuar nga MASHTI sqarime lidhur me institucionin përgjegjës për verifikimin e të dhënave në SMIA, procedurat konkrete për sigurimin e saktësisë së të dhënave, si dhe mënyrën e trajtimit të rasteve kur identifikohen mospërputhje ndërmjet të dhënave në sistem dhe gjendjes reale në terren.

³⁶ Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 5 dhe neni 7

³⁷ Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr. 02/2024 për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore.

³⁸ Udhëzimi Administrativ për përdorimin e Planit Individual të Arsimit (PIA); Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr. 02/2024 për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore; Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës.

³⁹ Plani Strategjik për Organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta në Arsimin Parauniversitar 2016–2021; Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr. 02/2024 për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore; Udhëzimi Administrativ për funksionimin e shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla (2014).

Divizioni për Arsim me Nevoja të Veçanta ka deklaruar se divizioni nuk ka përgjegjësi për administrimin e platformës SMIA dhe nuk posedon informata lidhur me procedurat e verifikimit të të dhënave në sistem. Megjithatë, kanë konfirmuar se janë në dijeni për ekzistimin e dallimeve dhe mospërputhjeve në numrat e raportuar për nxënësit me NVA.

- Pas kërkesës së auditimit për të sqaruar institucionin përgjegjës për këto procese, përgjigja është deleguar tek Divizioni për Administrimin e Platformave Digjitale (DAPD). Sipas përgjigjes së DAPD-së, përgjegjësia për saktësinë e të dhënave në SMIA rregullohet me UA⁴⁰, dhe është e shpërndarë në dy nivele: në nivel shkolle, drejtori i institucionit arsimor është përgjegjës për saktësinë e të dhënave të regjistruara;
- ndërsa në nivel komunal, DKA-të kanë përgjegjësi për mbikëqyrjen e saktësisë së të dhënave dhe respektimin e afateve të raportimit.

Po ashtu, DAPD ka sqaruar se Inspektorati i Arsimit ka mandat ligjor për të kontrolluar përputhshmërinë e dokumentacionit dhe për të urdhëruar korrigjimin e të dhënave në rast të mospërputhjeve. Megjithatë, Divizioni për Administrimin e Platformave Digjitale ka theksuar se ka vetëm rol teknik dhe nuk është përgjegjës për verifikimin përmbajtësor të të dhënave në terren.

Ndonëse përgjegjësitë dhe procedurat janë të përcaktuara formalisht në legjislacion, në praktikë mungon një mekanizëm funksional dhe i koordinuar për verifikimin sistematik të saktësisë së të dhënave në SMIA. Kjo evidentohet edhe nga fakti se, megjithëse strukturat relevante të MASHTI-t kanë konfirmuar ekzistimin e mospërputhjeve në të dhënat e SMIA-së dhe legjislacioni përcakton përgjegjësi për verifikimin e tyre, gjatë auditimit nuk u ofrua evidencë për analiza sistematike, raste të verifikuara apo masa të ndërmarra për korrigjimin e këtyre mospërputhjeve.

Rrjedhimisht, MASHTI nuk ka analiza të rregullta lidhur me trendet, luhatjet apo dallimet e evidentuara në të dhënat e raportuara nga komunat dhe shkollat. Mungesa e analizave të tilla kufizon mundësinë për identifikimin me kohë të problematikave në identifikimin dhe raportimin e nxënësve me NVA, si dhe ndikon në planifikim jo të saktë të kapaciteteve mbështetëse dhe politikave për arsimin gjithëpërfshirës.

Për më tepër, ka edhe mungesë të monitorimit sistematik të procesit të hartimit dhe zbatimit të Planeve Individuale të Arsimit (PIA). Edhe pse PIA konsiderohet instrument kyç për mbështetjen pedagogjike të nxënësve me NVA, nuk janë evidentuar analiza apo monitorime të rregullta nga MASHTI lidhur me cilësinë e PIA-ve, shkallën e zbatimit të tyre, realizimin e rivlerësimeve apo funksionalitetin e tyre në praktikë.

⁴⁰ Neni 10 të Udhëzimit Administrativ Nr. 25/2013 për Regjistrimin, Mbajtjen dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Sistemin e Arsimit.

Në nivel të planifikimit të kapaciteteve mbështetëse, auditimi ka evidentuar mungesë të analizave dhe monitorimit sistematik në nivel qendror lidhur me nevojat reale për staf profesional dhe mbështetës në shkolla. Edhe pse planifikimi dhe shpërndarja e stafit realizohet kryesisht në nivel komunal, auditimi nuk ka evidentuar analiza të konsoliduara nga MASHTI mbi disproporcionet ndërmjet komunave dhe shkollave sa i përket numrit të asistentëve, mësuesve mbështetës, psikologëve dhe pedagogëve në raport me numrin dhe nevojat e nxënësve me NVA.

Për pasojë, në praktikë janë evidentuar dallime dhe disproporcione të mëdha ndërmjet komunave dhe shkollave në raport me kapacitetet mbështetëse dhe nevojat reale të nxënësve, pa evidencë të mekanizmave sistematikë të monitorimit apo ndërhyrjes nga niveli qendror.

Mangësi janë evidentuar edhe në koordinimin dhe komunikimin ndërmjet MASHTI-t dhe Drejtorive Komunale të Arsimit. Gjatë auditimit nuk janë evidentuar mekanizma të rregullt dhe të strukturuar të komunikimit dhe raportimit ndërmjet nivelit qendror dhe atij komunal lidhur me sfidat në zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës, funksionimin e Ekipeve Vlerësuese Komunale, nevojat për staf mbështetës apo problematikat në identifikimin dhe mbështetjen e nxënësve me NVA.

Kjo situatë ka ndodhur për shkak se MASHTI nuk ka vendosur një mekanizëm të rregullt, funksional dhe të koordinuar për monitorimin e zbatimit të politikave të arsimit gjithëpërfshirës në nivel komunal dhe shkollor. Përgjegjësitë për raportimin, verifikimin dhe analizimin e të dhënave janë të shpërndara ndërmjet shkollave, DKA-ve, divizioneve brenda MASHTI-t dhe Inspektoratit të Arsimit, mirëpo në praktikë nuk ka një proces të qartë që siguron mbledhjen, verifikimin, analizimin dhe përdorimin sistematik të këtyre të dhënave për vendimmarrje.

Po ashtu, MASHTI nuk zhvillon takime të rregullta koordinuese me DKA-të për çështjet që lidhen me arsimin gjithëpërfshirës dhe në shumicën e rasteve informatat mbi problemet në terren nuk raportohen në mënyrë të strukturuar dhe sistematike. Për shembull, në rastin e mosfunksionimit të Ekipit Vlerësues Komunal në Komunën e Prishtinës, MASHTI ka deklaruar se është informuar vetëm në mënyrë joformale dhe pas një periudhe rreth tetë mujore nga paraqitja e problemit.

Kjo situatë tregon mungesë të mekanizmave efektivë të raportimit institucional për problematikat që ndikojnë drejtpërdrejt në identifikimin, vlerësimin dhe mbështetjen e nxënësve me NVA. Si rezultat, problemet në nivel komunal dhe shkollor nuk adresohen me kohë nga niveli qendror, duke ndikuar në funksionimin jo të standardizuar të sistemit të arsimit gjithëpërfshirës ndërmjet komunave dhe shkollave.

3.5 Praktikë e mirë ndërkombëtare në mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore – Rasti i Finlandës

Kjo praktikë paraqitet për të ilustruar se si një sistem i strukturuar mund të ndihmojë në identifikimin e hershëm, planifikimin dhe ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Finlanda konsiderohet një nga vendet me sistemin më të zhvilluar të arsimit gjithëpërfshirës në Evropë. Politikat arsimore finlandeze bazohen në parimin se çdo fëmijë duhet të marrë mbështetjen e nevojshme në kohën e duhur dhe, brenda klasës së rregullt dhe komunitetit të tij shkollor. Sistemi fokusohet në identifikimin e hershëm të nevojave, ndërhyrjen në kohë dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet sektorit të arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.

SISTEMI I IDENTIFIKIMIT TË HERSHËM NË FINLANDË

Monitorimi i fëmijëve nga lindja deri në hyrjen në shkollë përmes sistemit publik shëndetësor (Neuvola)

SI FUNKSIONON?



ÇFARË IDENTIFIKOHET HERSHËM?

Falë monitorimit të hershëm, shumë raste identifikohen vite para se fëmija të hyjë në shkollë.



Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet shëndetësisë, arsimit dhe shërbimeve sociale siguron që çdo fëmijë të marrë mbështetjen e duhur në kohën e duhur.



FINLANDË

Identifikimi i hershëm përmes sistemit shëndetësor

Një nga karakteristikat kryesore të modelit finlandez është identifikimi i hershëm i vështirësive zhvillimore përmes sistemit publik shëndetësor. Që nga lindja deri në hyrjen në shkollë, fëmijët monitorohen rregullisht nga klinikat publike të shëndetit të fëmijëve (Neuvola), të cilat ofrojnë kontrolle të planifikuara zhvillimore dhe shëndetësore⁴¹.

Sistemi me tre nivele të mbështetjes

Që nga viti 2011, Finlanda ka zbatuar modelin e njohur të mbështetjes me tre nivele (Kolmiportainen tuki), i cili konsiderohet një nga elementet kryesore të suksesit të arsimit gjithëpërfshirës.

- **Mbështetja e përgjithshme (General Support)** është niveli i parë dhe ofrohet për çdo nxënës që has vështirësi të përkohshme në të nxënë ose në pjesëmarrjen në procesin mësimor. Kjo mbështetje mund të përfshijë mësim shtesë, diferencim të aktiviteteve, materiale të përshtatura ose forma të tjera të ndihmës pedagogjike.
- Nëse mbështetja fillestare nuk është e mjaftueshme, nxënësi kalon në **mbështetje të intensifikuar (Intensified Support)**. Në këtë nivel realizohet një vlerësim pedagogjik më i detajuar dhe hartohet një plan individual i mbështetjes që përshkruan objektivat, masat mbështetëse, përgjegjësit dhe mënyrën e monitorimit të progresit.
- Niveli i tretë është **mbështetja speciale (Special Support)**, e cila ofrohet për nxënësit me nevoja më komplekse dhe afatgjata. Në këtë rast merret një vendim formal administrativ dhe përgatitet një plan individual i detajuar për organizimin e arsimit dhe mbështetjes⁴².

Ekipe multidisciplinare, mbështetja në klasë dhe monitorimi i progresit

Një nga elementet kryesore të sistemit finlandez është bashkëpunimi multidisiplinar ndërmjet mësimeve, mësuesve të arsimit special, psikologëve, infermierëve shkollorë dhe profesionistëve të tjerë, të cilët vlerësojnë dhe monitorojnë rregullisht nevojat e nxënësve. Prindërit konsiderohen partnerë aktivë dhe përfshihen vazhdimisht në planifikimin, zbatimin dhe rishikimin e mbështetjes së fëmijës.

Mbështetja organizohet kryesisht brenda klasës së rregullt përmes bashkëpunimit ndërmjet mësuesit të klasës dhe mësuesit të arsimit special, duke mundësuar që nxënësit me nevoja të

⁴¹ European Agency 2020 <https://www.european-agency.org/country-information/finland/assessment-within-inclusive-education-systems>

⁴² Finnish Educational System, European Commission (2024) https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/project-result-content/a79919d3-705d-4c58-83e1-d4d023217f94/The_Finnish_school_system.pdf

veçanta arsimore të marrin mbështetjen e nevojshme pa u shkëputur nga bashkëmoshatarët e tyre.

Për nxënësit që kanë nevojë për mbështetje të intensifikuar ose speciale hartohen plane individuale të dokumentuara, të cilat përmbajnë objektiva të qarta, masat mbështetëse, përgjegjësit dhe mekanizmat e monitorimit të progresit. Këto plane rishikohen periodikisht nga ekipet profesionale dhe prindërit, duke siguruar që mbështetja të përshtatet vazhdimisht me nevojat dhe zhvillimin e nxënësit.

3 Konkluzionet

Sistemi i arsimit gjithëpërfshirës në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta publike në Kosovë ka bazë ligjore dhe institucionale për identifikimin, vlerësimin dhe mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Megjithatë, zbatimi në praktikë nuk siguron ende mbështetje të qëndrueshme, të barabartë dhe funksionale për të gjithë nxënësit me NVA. Mangësitë janë të pranishme në të gjitha fazat e procesit, nga identifikimi dhe vlerësimi pedagogjik, deri te hartimi i PIA-ve, ofrimi i mësimdhënies së diferencuar, sigurimi i stafit mbështetës dhe monitorimi nga niveli qendror. Si rezultat, mbështetja për nxënësit me NVA vazhdon të varet në masë të madhe nga kapacitetet lokale, angazhimi individual i shkollave dhe mundësitë e prindërve, në vend se të funksionojë si sistem i standardizuar dhe i monitoruar në nivel vendi.

Identifikimi fillestar i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore realizohet kryesisht në nivel të shkollës, përmes vëzhgimeve të mësimdhënësve dhe bashkëpunimit me prindërit dhe stafin profesional. Megjithatë, mungesa e procedurave të unifikuara për identifikim, dokumentim, klasifikim dhe referim ka bërë që ky proces të zhvillohet në mënyra të ndryshme ndërmjet shkollave dhe komunave. Si rezultat, jo të gjithë nxënësit trajtohen sipas një qasjeje të njëjtë, ndërsa ekziston rreziku që disa nxënës të identifikohen ose të referohen me vonesë për vlerësim pedagogjik.

Mosfunksionimi i qëndrueshëm i Ekipeve Vlerësuese Komunale dhe mungesa e përbërjes së plotë profesionale kanë dobësuar mekanizmin kryesor institucional për vlerësimin pedagogjik të nxënësve me NVA. Në disa komuna, mungesa e profileve profesionale dhe e zyrtarëve përgjegjës ka bërë që procedura e vlerësimit të mos zbatohet në mënyrë të vazhdueshme. Për pasojë, një pjesë e nxënësve nuk kanë përfituar në kohë nga vlerësimi pedagogjik. Përderisa vlerësimi pedagogjik është bazë për hartimin e PIA-së dhe përcaktimin e formave të mbështetjes, këto vonesa e shtyjnë ofrimin e mbështetjes së strukturuar dhe kufizojnë mundësinë për ndërhyrje të hershme dhe efektive.

PIA-të nuk përdoren në mënyrë të njëtrajtshme si instrument për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e mbështetjes individuale për nxënësit me NVA. Edhe pse në disa shkolla janë evidentuar PIA të hartuara mirë dhe të përshtatura sipas nevojave të nxënësve, në raste të tjera mungojnë PIA aktive, dokumentacioni mbështetës ose dëshmitë për rishikimin periodik të tyre. Si rezultat, PIA nuk e përmbush gjithmonë funksionin e saj si dokument dinamik që përshtatet me progresin dhe nevojat e nxënësit.

Mësimdhënia e diferencuar zbatohet në disa shkolla përmes klasave burimore, materialeve didaktike, metodave alternative të komunikimit dhe aktiviteteve të përshtatura. Megjithatë, këto praktika nuk janë të standardizuara dhe mbeten kryesisht të varura nga iniciativa e shkollave, kapacitetet profesionale dhe resurset në dispozicion. Si rrjedhojë, nxënësit me NVA nuk përfitojnë në mënyrë të barabartë nga qasjet e përshtatura pedagogjike.

Drejtoritë Komunale të Arsimit nuk kanë krijuar kapacitete të mjaftueshme organizative për menaxhimin e arsimit gjithëpërfshirës. Mungesa e zyrtarëve të dedikuar, paqartësitë në strukturat organizative dhe koordinimi i pamjaftueshëm kanë dobësuar menaxhimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve mbështetëse në nivel komunal. Planifikimi dhe shpërndarja e asistentëve dhe mësuesve mbështetës nuk bazohet në analiza të plota të nevojave reale të nxënësve dhe shkollave. Numri i stafit mbështetës mbetet i pamjaftueshëm në raport me numrin dhe kompleksitetin e rasteve me NVA, ndërsa mbështetja në praktikë shpesh ofrohet vetëm për periudha të kufizuara. Kjo rrit ngarkesën e mësimeve dhe kufizon mundësinë që nxënësit me NVA të marrin mbështetje të vazhdueshme dhe të individualizuar gjatë procesit mësimor.

Mungesa dhe shpërndarja jo proporcionale e psikologëve dhe pedagogëve ka kufizuar mbështetjen profesionale që u nevojitet nxënësve me NVA, mësimeve dhe prindërve. Në mungesë të këtyre profileve, shkollat kanë kapacitete të kufizuara për identifikimin e nevojave, këshillimin psiko-social, mbështetjen e stafit mësimor dhe monitorimin e vazhdueshëm të rasteve më komplekse.

Angazhimi i asistentëve privatë nga prindërit është shfaqur si përgjigje ndaj mungesës së mbështetjes së mjaftueshme institucionale për nxënësit me NVA. Megjithatë, mungesa e udhëzimeve të qarta për bashkëpunimin ndërmjet shkollave dhe asistentëve privatë ka krijuar praktika të ndryshme ndërmjet komunave dhe shkollave. Kjo ka sjellë pabarazi në qasje, pasi mbështetja shtesë varet nga mundësitë financiare të prindërve, dhe njëkohësisht ka krijuar paqartësi institucionale lidhur me përgjegjësinë, konfidencialitetin dhe standardet profesionale brenda shkollave publike.

MASHTI nuk ka siguruar monitorim të mjaftueshëm dhe koordinim të rregullt për zbatimin e politikave të arsimit gjithëpërfshirës në nivel komunal dhe shkollor. Mungesa e analizave sistematike mbi të dhënat në SMIA, funksionimin e EVK-ve, zbatimin e PIA-ve dhe nevojat për staf mbështetës ka kufizuar aftësinë e nivelit qendror për të identifikuar dhe adresuar me kohë mangësitë në terren. Si rezultat, planifikimi dhe vendimmarrja nuk mbështeten mjaftueshëm në të dhëna të sakta dhe të verifikuara, duke kontribuar në zbatim jo të njëtrajtshëm të arsimit gjithëpërfshirës ndërmjet komunave dhe shkollave.

4 Rekomandimet

Bazuar në gjetjet e auditimit, janë identifikuar mangësi në procesin e identifikimit dhe vlerësimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, në planifikimin dhe zbatimin e mbështetjes pedagogjike, në sigurimin e kapaciteteve profesionale dhe mbështetëse, si dhe në monitorimin dhe koordinimin institucional të arsimit gjithëpërfshirës.

Për adresimin e këtyre mangësive dhe për përmirësimin e efektivitetit të sistemit të mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, rekomandimet për institucionet përgjegjëse janë si në vijim:

Rekomandojmë Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit që të:

1. Të sigurojë zbatimin e raportimit gjashtëmujor nga Drejtoritë Komunale të Arsimit për funksionimin e Ekipave Vlerësuese Komunale (EVK) dhe, mbi bazën e këtyre raporteve, të monitorojë rregullisht përbërjen, funksionalitetin, afatet e trajtimit të rasteve dhe realizimin e rivlerësimeve periodike, duke dokumentuar ndjekjen e çështjeve të identifikuara dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.
2. Të forcojë mekanizmat e monitorimit dhe verifikimit të të dhënave për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në SMIA, si dhe të sigurojë analiza të rregullta mbi trendet, mospërputhjet dhe nevojat e evidentuara në nivel vendi.
3. Të vendosë mekanizma të rregullt raportimi dhe koordinimi me Drejtoritë Komunale të Arsimit lidhur me zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës, funksionimin e EVK-ve, nevojat për staf mbështetës dhe sfidat e evidentuara në nivel komunal.
4. Të zhvillojë analiza të bazuara në nevoja për planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë të stafit mbështetës, përfshirë asistentët, mësuesit mbështetës, psikologët dhe pedagogët, në bashkëpunim me DKA-të.
5. Të hartojë udhëzime të qarta për trajtimin e rasteve kur nevojat për mbështetje të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore tejkalojnë kapacitetet e sistemit publik, duke përcaktuar rolet, përgjegjësitë dhe format e bashkëpunimit ndërmjet shkollave, prindërve dhe asistentëve privatë, me qëllim sigurimin e një qasjeje të standardizuar në të gjitha komunat.

Rekomandojmë Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) Prishtinë, Mitrovicë dhe Pejë që të:

6. Të sigurojnë funksionimin e plotë dhe në kohë të Ekipave Vlerësuese Komunale, duke garantuar përbërjen profesionale sipas kërkesave ligjore, përfshirë angazhimin e logopedit si anëtar të ekipit, si dhe trajtimin e kërkesave për vlerësim dhe rivlerësim brenda afateve të arsyeshme.
7. Të planifikojnë dhe të shpërndajnë stafin mbështetës bazuar në nevojat reale të shkollave dhe nxënësve, duke marrë parasysh numrin e nxënësve me NVA, llojin e nevojave dhe nivelin e mbështetjes së kërkuar.
8. Të sigurojnë monitorimin periodik të hartimit, rishikimit dhe zbatimit të Planeve Individuale të Arsimit (PIA) në shkolla, duke verifikuar që ato të hartohen për të gjithë nxënësit e vlerësuar, të përditësohen rregullisht dhe të reflektojnë nevojat individuale dhe progresin e nxënësve.
9. Të forcojnë kontrollin dhe verifikimin e të dhënave të raportuara nga shkollat në SMIA dhe të sigurojnë përditësimin e tyre të rregullt dhe të saktë.
10. Të planifikojnë dhe të shfrytëzojnë në mënyrë më efektive kapacitetet dhe burimet e disponueshme për angazhimin e asistentëve dhe stafit tjetër mbështetës, bazuar në nevojat e identifikuara të nxënësve me NVA, me qëllim zvogëlimin e rasteve kur prindërit detyrohen të sigurojnë mbështetje shtesë jashtë sistemit publik.
11. Të sigurojnë që shkollat të kenë qasje në materiale didaktike, mjete të përshtatura dhe mbështetje profesionale për zbatimin e mësimdhënies së diferencuar, si dhe të forcojnë kapacitetet e mësimdhënësve, asistentëve dhe stafit profesional përmes trajnimeve dhe mbështetjes praktike, me qëllim standardizimin e praktikave të mbështetjes pedagogjike për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Rekomandojmë DKA Prishtinë që të:

12. Të sigurojë funksionimin e pandërprerë të Ekipit Vlerësues Komunal dhe trajtimin me prioritet të rasteve të mbetura në pritje për vlerësim dhe rivlerësim pedagogjik.
13. Të finalizojë strukturën organizative për arsimin gjithëpërfshirës dhe të sigurojë funksionalizimin e plotë të pozitës përgjegjëse për këtë fushë, përfshirë plotësimin ose zëvendësimin e pozitave jo-funksionale, me qëllim garantimin e koordinimit, qartësisë së përgjegjësisë dhe vazhdimësisë së funksioneve.

Rekomandojmë DKA Pejë dhe DKA Mitrovicë që:

14. Të krijojnë, formalizojnë dhe funksionalizojnë pozitën përgjegjëse për arsimin gjithëpërfshirës në kuadër të strukturës organizative komunale, me përgjegjësi të qarta për koordinimin dhe menaxhimin e shërbimeve për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, si dhe të sigurojnë mekanizma që garantojnë vazhdimësinë e funksionit edhe gjatë mungesave të përkohshme të stafit.

Shtojca 1. Motivi i auditimit, kriteret, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Motivi i auditimit

Megjithëse arsimi gjithëpërfshirës është i rregulluar me ligje, udhëzime administrative dhe strategji kombëtare, një sërë treguesish të dokumentuar tregojnë se mbështetja për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA) në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta publike në Kosovë mbetet e pamjaftueshme dhe jo efektive. Këto mangësi janë evidentuar si në dokumentet strategjike të mëparshme, ashtu edhe në Strategjinë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2025–2030, e cila identifikon qasjen në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës si një nga sfidat kryesore strukturore që kërkon ndërhyrje të koordinuar institucionale.

Një nga treguesit kryesorë të problemit është mungesa e të dhënave të besueshme dhe të harmonizuara për nxënësit me NVA. Strategjia e Arsimit 2022–2026⁴³ thekson se mungesa e të dhënave është pengesa kryesore në adresimin e nevojave të kësaj kategorie të fëmijëve, ndërsa UNICEF⁴⁴ dhe Child Protection Index (2017)⁴⁵ evidentojnë se nuk ekziston një databazë e unifikuar kombëtare për fëmijët me nevoja të veçanta. Shkollat nuk raportojnë në mënyrë të njëtrajtshme, kategoritë e nevojave të veçanta nuk janë të unifikuara dhe mungon harmonizimi i sistemeve të raportimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe komunale. Kjo situatë krijon rrezik të lartë për planifikim jo të saktë të shërbimeve dhe burimeve.

Në këtë kontekst, edhe pse shkollat raportojnë raste të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, DKA-të nuk posedojnë të dhëna të konsoliduara mbi numrin e PIA, plane të cilat hartohen vetëm për fëmijët me nevoja të veçanta. Kjo kufizon ndjeshëm mundësinë për monitorim efektiv të mbështetjes individuale dhe për vlerësimin e progresit të nxënësve, duke rrezikuar që PIA-të të trajtohen më tepër si dokumente formale sesa si instrumente funksionale pedagogjike.

Një tregues tjetër i rëndësishëm lidhet me numrin e pamjaftueshëm të asistentëve dhe stafit mbështetës profesional. Sipas UA (MASHTI)⁴⁶, standardi i rekomanduar

⁴³ Strategjia e Arsimit në Kosovë 2022–2026 (MASHTI)

⁴⁴ UNICEF – Analysis of the Situation of Women and Children in Kosovo dhe UNICEF – raporte për arsimin gjithëpërfshirës dhe FNVA

⁴⁵ Child Protection Index 2.0 – Kosovo (2017)

⁴⁶ UA (MASHTI) Nr. 19/2023 Për Rolin, Detyrat Dhe Përgjegjësitë E Asistentit Për Fëmijë/Nxënës Me Nevoja Të Veçanta Arsimore

parasheh angazhimine një asistenti për një ose dy nxënës me NVA; megjithatë, raportet e UNICEF⁴⁷, Child Protection Index dhe Strategjia e Arsimit 2022–2026 tregojnë se ky standard nuk zbatohet në praktikë. Në shumë shkolla nuk ka asistentë fare, punësimi i tyre nga DKA-të shpesh vonohet, ndërsa mungon gjithashtu staf profesional si psikologë, logopedë dhe pedagogë specialë. Qendrat burimore, në shumë raste, operojnë me staf minimal dhe kapacitete të kufizuara.

Të dhënat komunale tregojnë se rritja e numrit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore nuk është shoqëruar me rritje proporcionale të numrit të asistentëve, duke ngritur shqetësime për mbingarkesë të mbështetjes dhe për zbatim formal të standardeve të përcaktuara me UA në fuqi (Tabela 1).

Një tjetër tregues i rëndësishëm lidhet me kapacitetet profesionale të mësimitdhënësve për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar⁴⁸ dhe Strategjia e Arsimit 2022–2026 parashohin mësimitdhënie të diferencuar dhe qasje të individualizuar, por raportet e UNICEF tregojnë se trajnimet për mësimitdhënësit janë të rralla dhe jo sistematike. Në praktikë, shumë mësues nuk njohin parimet e mësimit të diferencuar, nuk kanë aftësi për të zbatuar PIA-në në klasë dhe shpesh i perceptojnë nxënësit me NVA si ngarkesë shtesë, e jo si pjesë integrale të klasës⁴⁹.

Treguesi tjetër lidhet me funksionimin formal dhe jo efektiv të PIA-së. Sipas udhëzimeve për PIA⁵⁰, këto plane duhet të përmbajnë objektiva të matshme, të monitorohen dhe të rishikohen periodikisht. Megjithatë, gjetjet e UNICEF dhe analizat institucionale tregojnë se PIA-të shpesh hartohen vetëm për qëllime dokumentimi, pa objektiva të qarta, pa monitorim të progresit dhe pa rishikime të rregullta tremujore. Në shumë raste, asistentët dhe stafi mbështetës nuk përfshihen në hartimin dhe zbatimin e PIA-së.

Një tregues tjetër i rëndësishëm është procesi i dobët i vlerësimit të fëmijëve me NVA. UA-të parashohin funksionimin e ekipeve komunale për vlerësim profesional, të cilat duhet të përbëhen nga profesionistë multidisiplinarë, si psikologë, pedagogë, defektologë/pedagogë specialë dhe përfaqësues të arsimit, dhe të veprojnë në kuadër

⁴⁷ UNICEF Analysis of the Situation of Women and Children in Kosovo 2019

⁴⁸ Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës 2016

⁴⁹ UNICEF, Situation Analysis of Children with Disabilities in Kosovo; Strategjia e Arsimit 2022–2026

⁵⁰ Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 16/2017 për Planin Individual të Arsimit (PIA); Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 19/2023 për vlerësimin dhe mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

të Drejtorive Komunale të Arsimit ose në koordinim të ngushtë me to⁵¹. Këto ekipe kanë rol kyç në vlerësimin e nevojave arsimore të fëmijëve, orientimin e tyre në arsimin e rregullt apo në shërbime të specializuara dhe në rekomandimin e masave të duhura mbështetëse.

Megjithatë, raportet e UNICEF dhe Child Protection Index tregojnë se këto ekipe shpesh nuk funksionojnë në mënyrë efektive. Vendimet për vlerësim dhe mbështetje vonohen, mungojnë standarde të unifikuara të vlerësimit dhe, në shumë raste, diagnostikimi bëhet nga organizata joqeveritare, e jo nga sistemi publik, duke krijuar pabarazi në qasje dhe trajtim.

Së fundi, funksionimi i kufizuar i qendrave burimore përbën një tjetër tregues të rëndësishëm të problemit. Sipas UA (MASHTI)⁵², qendrat burimore duhet të jenë shtylla profesionale e arsimit gjithëpërfshirës, porraportet strategjike dhe analizat e UNICEF tregojnë se këto qendra përballen me staf pamjaftueshëm, mungesë specialistësh, fonde të kufizuara për pajisje didaktike dhe bashkëpunim të dobët me shkollat fillore publike. Kjo e kufizon ndjeshëm rolin e tyre në mbështetjen profesionale të mësimit dhe nxënësve me NVA.

Këta tregues, dëshmojnë për mangësi sistematike në ofrimin e mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe përbëjnë bazë të fortë për auditim, me qëllim vlerësimin e efektivitetit të masave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse dhe identifikimin e mundësive për përmirësim.

Materialiteti i këtij auditimi është i lartë, duke qenë se mbështetja për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore prek një pjesë të ndjeshme të popullatës shkollore në arsimin fillor, ndikon në barazinë në arsim dhe në zhvillimin afatgjatë të kapitalit njerëzor, si dhe përfshin burime publike të konsiderueshme, përgjegjësia për menaxhimin efektiv të të cilave u takon institucioneve qendrore dhe komunale.

Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivës së auditimit janë parashtruar pyetjet dhe nën pyetjet e auditimit si në vijim:

⁵¹ Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 19/2023 për vlerësimin dhe mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore; Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 16/2017 për Planin Individual të Arsimit (PIA)

⁵² Udhëzim Administrativ (Masht) Nr. 05/2024 Për Qendrat Burimore

Në çfarë mase mekanizmat për identifikimin, planifikimin dhe zbatimin e mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore janë efektivë dhe ndikojnë pozitivisht në procesin mësimor në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët publik?

Identifikimi i nevojave

- I. Si identifikohen dhe vlerësohen nevojat e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe në çfarë mase rezultatet e vlerësimit përdoren për planifikimin e mbështetjes?

Planifikim Mbështetja pedagogjike – (PIA dhe mësimdhënia e diferencuar)

- II. Si planifikohet dhe zbatohet mbështetja pedagogjike përmes Planeve Individuale të Arsimit (PIA) dhe mësimdhënies së diferencuar për të adresuar nevojat individuale të nxënësve me NVA?

Zbatim (Shërbimet mbështetëse - asistentë, staf profesional)

- III. Çfarë shërbimesh mbështetëse u ofrohen nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, si organizohen ato në praktikë dhe cilat janë ndikimet e tyre në procesin mësimor dhe në kohën efektive të të nxënësit në klasë?

Kriteret e auditimit

Pyetja 1.1 – Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave

Identifikimi dhe vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore duhet të realizohet në përputhje me kornizën ligjore dhe udhëzimet administrative në fuqi, përmes procedurave të qarta, të njëtrajtshme dhe të zbatuara në kohë në të gjitha komunat dhe shkollat. Procesi i vlerësimit duhet të mbështetet në funksionimin efektiv të ekipeve komunale për vlerësim profesional, të cilat duhet të jenë multidisiplinare, aktive dhe të afta për të marrë vendime brenda afateve të përcaktuara ose të arsyeshme.

Të dhënat për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore duhet të jenë të sakta, të plota, të përditësuara dhe të harmonizuara ndërmjet shkollave, komunave dhe nivelit qendror, duke mundësuar planifikim të saktë të shërbimeve dhe mbështetjes. Rezultatet e vlerësimit duhet të dokumentohen dhe të përdoren drejtpërdrejt për planifikimin e mbështetjes arsimore, përfshirë hartimin e PIA dhe përcaktimin e shërbimeve mbështetëse të nevojshme.

Ky proces duhet të jetë në përputhje me Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës⁵³, Udhëzimin Administrativ për vlerësimin pedagogjik⁵⁴ dhe profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, si dhe kërkesat e Strategjisë së Arsimit 2022–2026 ⁵⁵për identifikim të hershëm dhe përdorim të të dhënave të harmonizuara në planifikimin e mbështetjes⁵⁶.

Pyetja 1.2 – Planifikimi dhe zbatimi i mbështetjes pedagogjike (PIA dhe mësimdhënia e diferencuar)

Mbështetja pedagogjike për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore duhet të planifikohet dhe zbatohet përmes Planeve Individuale të Arsimit dhe mësimdhënies së diferencuar, në përputhje me nevojat individuale të nxënësve dhe parimet e arsimit gjithëpërfshirës⁵⁷. PIA-t duhet të përmbajnë objektiva të qarta dhe të matshme, masa konkrete mbështetëse dhe mekanizma për monitorimin dhe rishikimin periodik të progresit të nxënësve⁵⁸.

Zbatimi i PIA-së dhe i mësimdhënies së diferencuar duhet të reflektohet realisht në procesin mësimor, përmes përshtatjes së metodave të mësimdhënies, materialeve didaktike dhe vlerësimit të nxënësve⁵⁹. Mësimdhënësit dhe stafi mbështetës duhet të kenë kapacitetet dhe njohuritë e nevojshme për zbatimin praktik të PIA-së dhe për aplikimin e mësimdhënies së diferencuar në klasë, në mënyrë që mbështetja pedagogjike të mos mbetet vetëm në nivel dokumentimi formal.

PIA-t duhet të jenë dokumente funksionale që përmbajnë objektiva të matshme, masa konkrete pedagogjike dhe afate të qarta rishikimi, siç parashihet në Udhëzimin Administrativ për PIA-n, ndërsa mësimdhënia e diferencuar duhet të zbatohet në përputhje me Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar.

Pyetja 1.3 – Ofrimi i shërbimeve mbështetëse dhe ndikimi në procesin mësimor

Shërbimet mbështetëse për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, përfshirë asistentët e mësuesve, stafin profesional dhe mbështetjen nga qendrat burimore,

⁵³ Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar

⁵⁴ UA për Vlerësimin Pedagogjik të FNVA

⁵⁵ Strategjia e Arsimit 2022–2026

⁵⁶ UNICEF, *Situation Analysis*

⁵⁷ Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar; Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar në Kosovë

⁵⁸ Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 16/2017 për Planin Individual të Arsimit

⁵⁹ Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar në Kosovë

duhet të organizohen dhe të ofrohen në mënyrë të qëndrueshme dhe funksionale, në përputhje me nevojat e identifikuara të nxënësve. Këto shërbime duhet të jenë të mjaftueshme në numër, të shpërndara në mënyrë të drejtë dhe të mbështetura me kapacitete profesionale adekuate. Ofrimi i shërbimeve mbështetëse duhet të kontribuojë në përmirësimin e përfshirjes dhe përvojës arsimore të nxënësve me NVA, pa cenuar cilësinë dhe kohën efektive të të nxënësve në klasë për nxënës të tjerë. Roli i qendrave burimore duhet të jetë funksional dhe mbështetës për shkollat, përmes këshillimit profesional, trajnimeve dhe ofrimit të materialeve didaktike.

Ofrimi i këtyre shërbimeve duhet të jetë në përputhje me standardet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për asistentët e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore⁶⁰ dhe Udhëzimin Administrativ për qendrat burimore⁶¹, duke siguruar që mbështetja të jetë e qëndrueshme, e mjaftueshme dhe e koordinuar ndërmjet nivelit shkollor, komunal dhe qendror⁶².

Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi përqendrohet në vlerësimin e masave dhe mekanizmave të ndërmarrë për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore (NVA) në arsimin fillor publik në Kosovë. Auditimi do të përfshijë Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), në kuadër të Komunave: Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) në Prishtinë, Pejë dhe Mitrovicë, si dhe një përzgjedhje të shkollave fillore publike në këto komuna.

Brenda MASHTI-të, auditimi do të shqyrtojë punën e:

Departamentit të Arsimit Parauniversitar, me fokus në:

- Hartimin dhe zbatimin e politikave për arsimin inkluziv , përfshirë udhëzimet administrative, standardet dhe kornizat e kompetencave.
- Divizionin për Arsimin e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta

Në nivel komunal, auditimi do të shqyrtojë punën e Drejtoreve Komunale të Arsimit (DKA), me fokus në:

⁶⁰ UA Nr. 19/2023 për asistentët

⁶¹ UA Nr. 05/2024 për qendrat burimore

⁶² Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2025–2030

- Planifikimin e shërbimeve për fëmijët me NVA, punësimit dhe shpërndarjes së asistentëve, monitorimit të zbatimit të IEP-ve në shkolla dhe bashkëpunimit me MASHTI-n dhe profesionistët mbështetës.

Përzgjedhja e komunave në fusheveprim është bërë me qëllim të sigurimit të një pasqyre përfaqësuese të zbatimit të arsimit gjithëpërfshirës në kontekste të ndryshme komunale..

- Prishtina, si kryeqytet, ka kapacitete më të zhvilluara institucionale, qasje më të madhe në burime dhe prezencë më të lartë të stafit profesional.
- Peja dhe Mitrovica, në anën tjetër, janë përzgjedhur si komuna urbane të mesme, ku organizimi i shërbimeve mbështetëse për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, përfshirë funksionimin e ekipeve vlerësuese, angazhimin e asistentëve dhe bashkëpunimin me qendrat burimore, mund të përballlet me sfida të ndryshme strukturore dhe organizative.

Po ashtu, Strategjia e Arsimit 2022–2026 dhe Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2025–2030 theksojnë pabarazitë ndërmjet komunave në aspektin e kapaciteteve administrative, burimeve njerëzore dhe ofrimit të shërbimeve mbështetëse.

Fushëveprimi i auditimit nuk do të përfshijë vlerësimin teknik të infrastrukturës shkollore dhe investimeve kapitale, meqë këto çështje përbëjnë një fushë të veçantë teknike dhe do të kërkonin auditim të ndarë. Fokusimi i auditimit mbetet në aspektet institucionale, pedagogjike dhe të shërbimeve mbështetëse të arsimit gjithëpërfshirës.

Auditimi do të përfshijë periudhën 2022–2025, me fokus në vitet e fundit shkollore për të cilat ekziston dokumentacion dhe të dhëna të disponueshme. Kjo periudhë është përzgjedhur me qëllim që auditimi të mbulojë fazën e zbatimit të politikave dhe masave aktuale për arsimin gjithëpërfshirës, përfshirë Strategjinë e Arsimit 2022–2026, Udhëzimin Administrativ Nr. 19/2023 për asistentët për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2024 për qendrat burimore

Metodologjia

Metodologjia e auditimit do të fokusohet në vlerësimin e efektivitetit të mekanizmave për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore (NVA) në arsimin fillor publik, duke kombinuar analizën e dokumentacionit, të dhënave administrative dhe informatat e mbledhura nga intervistat dhe vizitat në terren.

Auditimi do të përdorë një kombinim të metodave cilësore dhe sasore për të siguruar mbulim të plotë të pyetjeve të auditimit dhe provave.

Metodat kryesore do të përfshijnë:

- **Analizë e dokumenteve:** Do të analizohen ligjet, udhëzimet administrative, strategjitë, planet e veprimit, raportet zyrtare, dokumentet komunale dhe shkollore, përfshirë Planet Individuale të Arsimit (PIA), vendimet e ekipeve komunale të vlerësimit dhe raportimet në EMIS/SMIA. Kjo analizë do të shërbejë për vlerësimin e përputhshmërisë së praktikave me kornizën ligjore dhe strategjike.
- **Analizë të të dhënave administrative:** Do të shqyrtohen të dhënat e disponueshme në sistemet zyrtare të MASHTI-t (EMIS/SMIA), si dhe të dhëna statistikore të arsimit parauniversitar, për të vlerësuar shtrirjen e mbështetjes për nxënësit me NVA, numrin e asistentëve, përdorimin e PIA-ve dhe dallimet ndërmjet komunave të përfshira në auditim.
- **Intervista gjysmë të strukturuar:** Do të realizohen intervista me zyrtarë të MASHTI-t, Drejtorive Komunale të Arsimit, drejtorë shkollash, mësime dhënë, asistentë dhe staf profesional, me qëllim të kuptimit të praktikave reale, sfidave dhe perceptimeve lidhur me zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës.
- **Për më tepër, në një numër të përzgjedhur shkollash** që do të vizitohen gjatë punës në terren, parashihet realizimi i intervistave ose bisedave informuese me prindër të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, me qëllim të marrjes së perspektivës së përfituesve mbi ofrimin e mbështetjes arsimore dhe bashkëpunimin me shkollën.
- **Vizita në terren në shkolla fillore publike:** Në kuadër të auditimit do të realizohen vizita në shkollat e përzgjedhura, për të vëzhguar organizimin e procesit mësimor, zbatimin e PIA-ve dhe bashkëpunimin ndërmjet aktorëve shkollorë, pa ndërhyrë në procesin mësimor.
- **Analizë krahasuese ndërmjet komunave,** për të identifikuar dallime, praktika të mira dhe mangësi strukturore në zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës.

Përshkrimi i sistemit

Sistemi i arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë është i organizuar në tre nivele kryesore: nivel qendror, nivel komunal dhe nivel shkollor; dhe synon të sigurojë qasje të barabartë dhe mbështetje adekuate për të gjithë nxënësit, përfshirë nxënësit me nevoja

të veçanta arsimore (NVA). Ky sistem mbështetet në një kornizë ligjore dhe strategjike që parashikon identifikimin e hershëm të nevojave, planifikimin individual të mbështetjes dhe ofrimin e shërbimeve pedagogjike dhe profesionale brenda shkollave të rregullta.




Figura 8 Procesi i identifikimit, planifikimit dhe ofrimit të mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në arsimin fillor publik

Figura 6 paraqet në mënyrë të thjeshtuar rrjedhën e procesit të identifikimit, planifikimit dhe zbatimit të mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, mbi të cilën bazohet përshkrimi i sistemit në vijim.

Niveli qendror

Në nivel qendror, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave arsimore, legjislacionit dhe udhëzimeve administrative që rregullojnë arsimin gjithëpërfshirës. MASHTI përcakton standardet për identifikimin dhe vlerësimin e nxënësve me NVA, përgatit strategji dhe plane veprimi që synojnë përfshirjen e tyre në arsimin publik

dhe nxjerr udhëzime për hartimin dhe zbatimin e Planeve Individuale të Arsimit (PIA).

Po ashtu, MASHTI është përgjegjëse për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të të dhënave arsimore, përfshirë Sistemin për Menaxhimin e Informatave në Arsim (EMIS/SMIA), si dhe për monitorimin e zbatimit të politikave përmes mekanizmave të mbikëqyrjes dhe inspektimit arsimor. Nëpërmjet këtyre funksioneve, MASHTI ka rol kyç në sigurimin e një qasjeje të njëtrajtshme dhe të koordinuar për arsimin gjithëpërfshirës në nivel kombëtar.

Niveli komunal

Në nivel komunal, përgjegjësitë kryesore për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës u takojnë Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA). Komunat janë përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin praktik të politikave arsimore në shkollat e tyre, përfshirë menaxhimin e stafit arsimor dhe mbështetës, financimin e aktiviteteve përfshirëse dhe koordinimin e shërbimeve për nxënësit me NVA.

DKA-të kanë rol të rëndësishëm në procesin e identifikimit dhe vlerësimit të nxënësve me NVA, përmes ekipeve komunale për vlerësim profesional, si dhe në marrjen e vendimeve për ofrimin e mbështetjes, përfshirë angazhimin e asistentëve dhe shërbimeve profesionale. Ato gjithashtu sigurojnë bashkëpunimin ndërmjet shkollave, familjeve dhe aktorëve të tjerë të komunitetit, si dhe raportojnë periodikisht te MASHTI mbi zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe përdorimin e PIA-ve.

Niveli shkollor

Shkollat fillore publike përbëjnë nivelin ku arsimi gjithëpërfshirës zbatohet drejtpërdrejt në praktikë. Në këtë nivel, drejtorët e shkollave, mësime dhënësit, asistentët dhe stafi profesional janë përgjegjës për identifikimin e hershëm të vështirësive në të nxënë, për zbatimin e Planeve Individuale të Arsimit, për mësime dhënësin e diferencuar dhe për integrimin e nxënësve me NVA në klasat e rregullta.

Shkollat janë gjithashtu përgjegjëse për bashkëpunimin e vazhdueshëm me prindërit dhe DKA-të, për dokumentimin e progresit të nxënësve dhe për raportimin e të dhënave në sistemet përkatëse. Në kuadër të arsimit gjithëpërfshirës, shkollat duhet të sigurojnë një mjedis mësime mbështetës, përfshirë staf të trajnuar, asistentë mësime dhe organizim pedagogjik që u përgjigjet nevojave individuale të nxënësve, edhe pse aspektet teknike të infrastrukturës fizike nuk janë pjesë e këtij auditimi.

Shtojca 2. Perspektiva e prindërve mbi mbështetjen e nxënësve me NVA

Për të siguruar edhe perspektivën e përfituesve të drejtpërdrejtë të sistemit, auditimi realizoi një pyetësor me prindërit e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore që kanë kaluar procesin e vlerësimit nga Ekipet Vlerësuese Komunale (EVK).

Pyetësoni u dërgua në mënyrë elektronike tek 54 prindër të nxënësve të vlerësuar nga EVK, kontaktet e të cilëve u siguruan përmes shkollave të përfshira në mostër. Auditimi zgjodhi formën elektronike të komunikimit për të garantuar konfidencialitetin e pjesëmarrësve dhe për të krijuar mundësi që prindërit të shprehnin lirshëm përvojat dhe shqetësimet e tyre lidhur me mbështetjen që marrin fëmijët e tyre në sistemin arsimor. Numri i prindërve të kontaktuar përfaqëson pothuajse të gjithë prindërit e nxënësve të vlerësuar nga EVK në mostrat e auditimit, përveç rasteve kur shkollat nuk posedonin adresa elektronike të kontaktit.

Nga 54 pyetësorë të dërguar janë pranuar 15 përgjigje të plota (Shkalla e përgjigjes 28%), të cilat ofrojnë një pasqyrë shtesë mbi funksionimin e sistemit të mbështetjes nga perspektiva e prindërve. Edhe pse rezultatet nuk synojnë të jenë statistikisht përfaqësuese për të gjithë prindërit e nxënësve me NVA në Kosovë, ato ofrojnë evidencë cilësore të vlefshme dhe ndihmojnë në validimin e gjetjeve të evidentuara gjatë auditimit në nivel të MASHTI-t, DKA-ve dhe shkollave.

Përgjigjet e prindërve konfirmojnë në masë të madhe sfidat e identifikuar gjatë auditimit, veçanërisht sa i përket procesit të vlerësimit pedagogjik, zbatimit të Planeve Individuale të Arsimit (PIA), mungesës së asistentëve dhe nevojës për mbështetje më të individualizuar për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Gjetjet kryesore nga pyetësorët

Përfshirja e prindërve në hartimin e PIA-së

Rezultatet tregojnë se shumica e prindërve janë të përfshirë në procesin e hartimit të Planeve Individuale të Arsimit (PIA). Nga 15 prindër që iu përgjigjën anketës, 12 (80%) kanë deklaruar se kanë qenë personalisht të përfshirë në hartimin e PIA-së për fëmijën e tyre, ndërsa 3 (20%) kanë deklaruar se nuk kanë qenë të përfshirë.

Po ashtu, 11 nga 15 prindër (73%) kanë deklaruar se për vitin shkollor 2025/2026 fëmija i tyre ka PIA aktive. Megjithatë, disa prindër kanë theksuar se objektivat e PIA-ve shpesh mbeten të njëjta për periudha të gjata kohore dhe nuk reflektojnë gjithmonë progresin apo nevojat aktuale të fëmijës.

Mungesa e asistentëve paraqet shqetësimin kryesor të prindërve

Nga përgjigjet e prindërve, tema më e përsëritur lidhet me mungesën e asistentëve dhe pamjaftueshmërinë e mbështetjes individuale gjatë procesit mësimor.

Prindërit kanë kërkuar:

- sigurimin e asistentëve gjatë gjithë orarit mësimor;
- rritjen e numrit të asistentëve të financuar nga institucionet publike;
- uljen e barrës financiare për familjet që aktualisht sigurojnë vetë mbështetjen;
- si dhe mekanizma më të qartë institucionale për adresimin e nevojave të fëmijëve.

Disa prindër kanë deklaruar se në mungesë të asistentëve apo mësuesve mbështetës, fëmijët mbesin pa mbikëqyrje adekuate gjatë pjesëve të caktuara të ditës mësimore. Sipas tyre, kjo situatë jo vetëm që ndikon në procesin e të nxënës, por mund të krijojë edhe pasiguri për fëmijët që kanë nevojë për mbështetje të vazhdueshme.

Nevoja për më shumë mbështetje profesionale

Përveç asistentëve, prindërit kanë evidentuar nevojën për angazhim më të madh të psikologëve, pedagogëve, logopedëve dhe profesionistëve të tjerë mbështetës.

Disa prej tyre kanë theksuar mungesën e logopedëve në institucionet publike, ndërsa të tjerë kanë kërkuar që shkollat të ofrojnë forma shtesë të mbështetjes si ergoterapia, këshillimi psikologjik dhe programe të personalizuar zhvillimore. Prindërit vlerësojnë se nevojat e fëmijëve me NVA shpesh tejkalojnë mbështetjen që mund të ofrohet vetëm përmes procesit të rregullt mësimor.

Integrimi social dhe zhvillimi funksional

Një numër prindërisht kanë theksuar se sfida më e madhe nuk lidhet vetëm me arritjet akademike, por me integrimin social dhe zhvillimin e pavarësisë së fëmijëve.

Prindërit kanë kërkuar më shumë aktivitete që nxisin:

- komunikimin dhe ndërveprimin me bashkëmoshatarët;
- pjesëmarrjen në aktivitete jashtë klasës;
- zhvillimin e vetëbesimit dhe pavarësisë;
- si dhe përgatitjen psikologjike të nxënësve për kalimin nga një nivel shkollimi në tjetrin.

Sipas tyre, fëmijët me NVA kanë nevojë jo vetëm për mbështetje akademike, por edhe për stimulim social, emocional dhe funksional, në mënyrë që të jenë më të përfshirë në jetën shkollore.

Nevoja për mësimdhënie më praktike dhe të diferencuar

Një temë tjetër e evidentuar nga prindërit lidhet me nevojën për metoda më praktike dhe më fleksibile të mësimdhënies. Disa prej tyre kanë vlerësuar se mësimi tradicional dhe akademik shpesh është i vështirë për t'u kuptuar nga fëmijët me NVA dhe nuk adreson plotësisht potencialin e tyre individual.

Prindërit kanë sugjeruar:

- më shumë aktivitete laboratorike;
- mësim në natyrë;
- aktivitete muzikore dhe artistike;
- përdorim të metodave alternative të komunikimit;
- si dhe përshtatje më të madhe të objektivave mësimore sipas aftësive dhe interesave të fëmijëve.

Në përgjithësi, përgjigjet e prindërve tregojnë se, ndonëse vlerësohen përpjekjet e shkollave dhe stafit arsimor për mbështetjen e nxënësve me NVA, mbeten sfida të konsiderueshme në sigurimin e asistencës së mjaftueshme, qasjes multidisiplinare dhe mbështetjes së individualizuar. Prindërit e shohin si prioritet rritjen e numrit të asistentëve, zgjerimin e shërbimeve profesionale dhe krijimin e mundësive më të mëdha për integrim social dhe zhvillim funksional të fëmijëve. Këto perceptime përputhen në masë të konsiderueshme me gjetjet e evidentuara gjatë auditimit në nivel të shkollave, komunave dhe institucioneve qendrore.

Shtojca 3. Përmbledhje e analizës së Planeve Individuale të Arsimit (PIA) në shkollat e përzgjedhura për auditim

Tabela 11 Përmbledhje e analizës së mostrave të PIA-ve sipas shkollave

Komuna	Shkolla	Nr. i rasteve të analizuar	PIA aktive	Mangësitë kryesore të evidentuara	Praktika pozitive / komente
Prishtinë	Emin Duraku	9	1	Mungesë e PIA-ve për shumicën e rasteve; mungesë e rivlerësimit; raport i panënskruar; dokumentacion mbështetës i paplotë.	—
Prishtinë	Hasan Prishtina	10	9	Një rast pa PIA për shkak të mungesës së vlerësimit formal; mangësi në dokumentacion dhe në procesin e rivlerësimit.	Dokumentacion relativisht më i strukturuar dhe praktika më të organizuara të monitorimit pedagogjik.
Prishtinë	Ismail Qemali	13	10	Mungesë e kërkesave formale për vlerësim; mungesë dokumentacioni mbështetës; mungesë e diagnozës në disa PIA; mungesë e rivlerësimit për shumicën e rasteve.	PIA aktive në shumicën e rasteve të analizuar.
Prishtinë	Meto Bajraktari	7	6	Raste në pritje për vlerësim; disa raste me PIA aktive pa vlerësim formal; një rast pa PIA dhe pa vlerësim pedagogjik.	Rishikim i PIA-ve dy herë në vit; përfshirje e rregullt e nxënësve me NVA në aktivitete shkollore dhe sociale.
Prishtinë	Ditura	—	—	Në vitet paraprake janë evidentuar raste me PIA pa vlerësim pedagogjik dhe raste pa evidencë për ekzistimin e PIA-ve.	Nuk kishte nxënës me NVA të evidentuar për vitin shkollor 2025/2026.
Mitrovicë	Migjeni	4	4	Mungesë e raporteve formale të vlerësimit pedagogjik në dosje; dokumentet përkatëse të vlerësimit nuk janë gjetur; PIA të panënskruara në disa raste.	Shkolla kishte dokumente të brendshme ku evidentohet nevoja për mbështetje përmes PIA-së.
Mitrovicë	Andon Zako Çajupi	5	4	Mungesë e kërkesave formale për vlerësim; mungesë e raporteve të vlerësimit komunal dhe dokumentacionit mbështetës; një rast në proces vlerësimi pa PIA aktive.	Deklarata të prindërve për pëlqim dhe përpjekje për dokumentim të bashkëpunimit me prindërit.

Komuna	Shkolla	Nr. i rasteve të analizuara	PIA aktive	Mangësitë kryesore të evidentuara	Praktika pozitive / komente
Mitrovicë	Abdullah Shabani	1	0	Nxënësi i vlerësuar nuk posedonte PIA aktive; raste të tjera të identifikuar nga shkolla nuk kishin kaluar procesin formal të vlerësimit; mungesë e stafit profesional mbështetës.	Shkolla ofron mbështetje pedagogjike brenda kapaciteteve ekzistuese dhe dokumenton përpjekjet për trajtimin e rasteve.
Pejë	Ramiz Sadiku	8	8	Në një rast mungonte raporti formal i vlerësimit dhe dokumentacioni mbështetës për bazën e kategorizimit.	Dokumentacion relativisht më i strukturuar; PIA të hartuara për të gjitha rastet në mostër.
Pejë	Asdreni	8	2	Shumica e rasteve pa PIA, ndonëse nxënësit ishin evidentuar nga shkolla si raste me nevojë për mbështetje pedagogjike.	—

Shënim: Tabela paraqet përmbledhjen e analizës së dosjeve dhe dokumentacionit të PIA-ve në shkollat e përzgjedhura. Të dhënat janë përdorur për të vlerësuar nëse PIA-të hartohen, dokumentohen dhe rishikohen në mënyrë të standardizuar.

Shtojca 4. Letërkonfirmimet

08-470/04-0343051/26
24.07.26

REPubLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KOMUNA E MITROVICËS JUGORE
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari Org. Auditimi	Drejtori Kod. Kod. Kod.	Nr. Prot. Dr. Prot. Prot. No.	Nr. Fajlove Dr. Shtetitoria No. Fajlove
06	47	1458	1

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës
“Mbështetja e Nxënësve me Nevoja të Veçanta në Shkollat Filllore dhe të Mesme të Ulëta në Kosovë”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Mitrovicë – 22.07.2026

I/e nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Mbështetja e Nxënësve me Nevoja të Veçanta në Shkollat Filllore dhe të Mesme të Ulëta në Kosovë” (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetar i Komunës së Mitrovicës

Faton Peci
Faton Peci



		REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO		KOMUNA E PEJËS OPŠTINA PEÇ MUNICIPALITY OF PEJA		
Org. Kod	Shif. Klasif.	Nr. Prot.	Nr. i Fasqes			
Org. Unit	Klasif. Kod	Prot. No.	Br. Ekrane			
06	47	1458	1			
				Nr./D. 297 Data/Date 13/08/26		

ZYRA E KRYETARIT / KANCELARIJA GRADONAÇELNIKA / MAYOR'S OFFICE	
REFERENCE:	297 / 2026
DATA / DATUM / DATE:	13 / Gusht / 2026
PËR / ZA / TO:	Zyrën Kombëtare të Auditimit
PËRMES / PREKO / THROUGH:	Zyra e Kryetarit
NGA / IZ / FROM:	Gazmend Muhaxheri / Kryetar i Komunës së Pejës
TEMA / SUBJEKAT / SUBJECT:	Pajtueshmërië me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm, auditimit të performancës.

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës "Mbështetja e Nxënësve me Nevoja të Veçanta në Shkollat Filllore dhe të Mesme të Ulëta në Kosovë", dhe për zbatimin e rekomandimeve.

I/e nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit "Mbështetja e Nxënësve me Nevoja të Veçanta në Shkollat Filllore dhe të Mesme të Ulëta në Kosovë" (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Sinqerisht
Gazmend MUHAXHERI
Kryetar





Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës